
Perspektiva e një të riu serb në Kosovë

Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë

Perspektiva e një të riu serb në Kosovë

Faqe 3

Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë

Faqe 33

Prishtinë, 2012

Copyright © 2012. Projekti për Marrëdhënie Etnike – Kosovë (PER-K) dhe Demokraci në zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar etj., pa lejen me shkrim të PER-K dhe D4D.

Përgatitur nga:

Leon Malazogu, Viktor Popoviq dhe Shpend Emini,

me ndihmë hulumtuese të:

Selatin Kllokoqi dhe Flora Smith.

Redaktuar në shqip nga: Valmir Ismaili

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Masat për ndërtim të mirëbesimit në Kosovë” me përkrahje financiare nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe përkrahje shtesë nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD), një projekt i German Marshall Fund të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. Përmbajtja e këtij raporti është krejtësisht përgjegjësi vetëm e Projektit për Marrëdhënie Etnike - Kosovë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si diçka që reflekton pozicionin e Bashkimit Evropian, BTD-së, German Marshall Fund apo Ambasadës së Mbretërisë së Holandës.

Perspektiva e një të riu serb në Kosovë

Prishtinë, Mars 2012

Përmbajtja

Përmbledhje, 5

Hyrje, 7

Papunësia dhe pjesëmarrja, 9

Varësia e tepërt në sektorin publik, 15

Pengesat në përfshirjen e sektorit privat, 17

Pjesëmarrja, motivimi dhe identiteti kulturor, 20

Humbja e busullës, 23

Arsimi dhe Migrimi, 24

Kthimi apo mbajtja e rinisë?, 26

Avantazhi krahasues i serbëve të Kosovës, 28

Rekomandimet, 30

Përmbledhje

Kosova duhet të bëjë më shumë që t'i përmbushë nevojat e të rinjve serbë. Përderisa Kosova është fokusuar në kthimin e serbëve të moshuar, të rinjtë e këtij komuniteti shohin pak arsye për të qëndruar. Dëshira për t'u larguar mund të jetë pjesë e një trendi më afatgjatë për migrim në zonat urbane.

Papunësia mbetet e lartë në krejt Kosovën, por në të njëjtën kohë ajo konsiderohet si sfidë jetësore në mesin e popullatës serbe. Punësimi në sektorin publik është një mënyrë e rëndësishme që komuniteti serb të krijoj një lloj ndjenje të pronësisë në institucionet e Kosovës. Madje, edhe hapja e një dyqani të vogël ushqimor kërkon një nivel minimal të sigurisë dhe një planifikim afatgjatë, i cili mund të vije vetëm me përfaqësim adekuat.

Nën-përfaqësimi i komunitetit serb është kryesisht rezultat i politikës së Beogradit që të parandaloj serbët që t'i bashkohen institucioneve të Kosovës. Përderisa shumë serbë të zakonshëm i bojkotojnë institucionet, ata që i pranojnë ato marrin pozita të larta. Të tjerë serbë të kualifikuar, kanë përshtypjen që aplikimi për pozita të larta është i kotë.

Ekziston një mirëkuptim te të gjitha palët që një përfaqësim më i mirë do të kontribuonte në stabilitetin politik dhe në gjithpërfshirje. Komuniteti serb gjithnjë e më shumë shpreh gatishmëri për të bashkëpunuar me autoritetet kosovare.

E ardhmja duket të jetë premtuese dhe në të njëjtën kohë edhe shqetësuese. Përderisa ka mundësi të ndryshme, politizimi i serbëve të Kosovës ka ruajtur nivelet e punësimit të paraluftës, duke ju siguruar serbëve të ardhura me bollëk. Izolimi nga tranzicioni në ekonominë e tregut vetëm se e ka shtyrë të pashmangshmen.

Përderisa serbët varen më shumë në paga, pensione, ndihma sociale, kursime dhe shitje të pronave, shqiptarët varen më shumë nga fitimet në biznes dhe qiratë, kreditë, remitancat

dhe ndihmat nga të afërmit/shoqëria. Përfundimi i mosmarrëveshjes politike ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës lehtëson politikisht serbët e Kosovës, por sjellë shqetësime ekonomike pasi që ata shqetësohen se Beogradi do t'ua zvogëloj pagat dhe pensionet.

Qeveria e Kosovës Kosova duhet t'a bëjë pjesën e vetë që të lehtësojë tranzicionin ekonomik të serbëve të Kosovës dhe të krijoj besim në marrëdhëniet shumicë-pakicë në tërë vendin. Kuota e paraparë për punësim të pakicave duhet të qartësohet me një shifër të saktë për serbët. Komunitetet duhet të dinë se çfarë niveli i përfaqësimit u takon, kështu që ata mund të kërkojnë llogaridhënie nga të zgjedhurit e tyre. Pasi që me privatizimin e kompanive shënon rritje edhe sektori privat, duhet të gjenden mënyra për të zhvilluar ndërmarrësinë në radhët e komunitetit serb.

Një marrëveshje në mes të Prishtinës dhe Beogradit për të zbatuar dispozitat e Ahtisaarit për arsim dhe shëndetësi duhet të bëhet prioritet. Këta dy sektorë, janë thelbësorë për stabilizimin dhe mirëqenien e komunitetit serb. Për të vënë në funksion një pjesë të madhe të tokës që është në pronësi të serbëve, qeveria qendrore duhet të promovojë bujqësinë në nivel të gjerë në mënyrë që të punësohen me mijëra shqiptarë dhe serbë dhe që të përmirësohet tregtia, duke zëvendësuar shumë nga ushqimet që importohen.

Shërbimet duhet të koncentrohen në Graçanicë e cila duhet të shndërrohet në një zonë të re urbane, ku serbët nga Anamorava dhe pjesët tjera të Kosovës mund të mblidhen së bashku. Duhet të sigurohet banimi për familjet në rritje. Krijimi i një mjedisi urban me kulturë, argëtim dhe sport është thelbësor në sigurimin e qëndrimit të të rinjve serb.

Hyrje

Komuniteti serb mbetet pjesërisht i integruar në sferat politike dhe ekonomike të Kosovës. Pjesëmarrja e tyre e ulët e zvogëlon ndikimin e tyre në vendimmarrje të politikave, gjë që reflekton në paaftësi për të ndjekur interesat e tyre. Perspektiva e komunitetit serb në Kosovë varet shumë nga integrimi i këtij komuniteti në jetën institucionale dhe shoqëri. Çështjet në diskutim janë më pak politike dhe më shumë praktike. Duke pasur parasysh faktin që sektori publik është punëdhënësi më i madh në Kosovë, përveç punësimit në shërbimin civil, nuk ka edhe shumë mundësi të tjera për të rinjtë serbë.

Ky punim vlerëson perspektivën e të rinjve serbë në Kosovë në aspekt të punësimit, përfaqësimit, motivimit, aftësive dhe arsimimit. Raporti identifikon sfida dhe mundësi në mbajtjen e të rinjve serbë në Kosovë. Mungesa e vendeve të punës, aftësive të gjuhës, dëshira për migrim në Serbi për edukim, nevoja për të udhëtuar për shërbime elementare dhe perceptimi i pasigurisë politike e mbanë komunitetin në një gjendje të padefinuar.

Disa serbë pretendojnë se ata “fleenë me bagazh gati”, një deklaratë që tregon pasigurinë e tyre për të pasur vend në të ardhmen e Kosovës. Sidoqoftë, një numër në rritje i serbëve janë duke ndërtuar dhe riparuar shtëpitë e tyre, një shenjë e përkushtimit të tyre për të qëndruar. Për të inkurajuar këto përpjekje, qeveria qendrore dhe komunat e reja duhet që të punojnë me komunitetin për të rinisur dhe përkrahur këtë optimizëm të ri.

Statistikat në Kosovë janë të pakta dhe të pasakta, por të dhënat për komunitetin serb nuk ekzistojnë fare apo janë të vjetra, që paraqesin sfida për politikbërje adekuate. Në mënyrë që të merret një pamje më e saktë, ky punim trajton

çështjet që prekin të rinjtë serbë në Kosovë dhe ofron rekomandime se si të rriten mundësitë për punë.

Ky punim fokusohet në komunitetin serb në jug të Ibrit. Në disa rrethana, këto të gjetura janë në masë të madhe të aplikueshme edhe në komunat në veri. Edhe pa sfidën e veriut, problemet që prekin komunitetin serb janë të mëdha. Edhe pse ekzistojnë disa zgjidhje, sfida kryesore është mungesa e vullnetit politik.

Papunësia dhe pjesëmarrja

Papunësia në Kosovë është veçanërisht e madhe tek serbët dhe paraqet jo vetëm një sfidë sociale por po ashtu edhe një sfidë ekzistenciale. Në një shoqëri të ndarë post-konfliktuozë siç është Kosova, numri i pakicave të punësuar në sektorin publik është i rëndësishëm.

Punësimi i komuniteteve në sektorin publik ka qenë subjekt i një raporti të botuar në vitin 2010 nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Në këtë raport, janë rekomanduar një sërë masash për të rritur punësimin e pakicave përmes sektorit publik në Kosovë. Disa nga rekomandimet kryesore kanë të bëjnë me: (a) harmonizimin e procedurave të punësimit në ndërmarrjet publike; (b) reklamimi i pozitive përmes rrjetit për shkëmbim të informatave ndërmjet nivelit qendror dhe lokal; (c) hartimi i udhëzimeve dhe kriterëve profesionale për pozita specifike; dhe (d) aplikimi i një sistemi të kuotës ku të gjitha komunitetet do të ishin të përfaqësuara në mënyrë të barabartë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike ¹.

Për një kohë të gjatë serbët i kanë rezistuar punësimit në institucionet e Kosovës dhe kjo është një nga arsyet për shkallën e lartë të papunësisë. Sidoqoftë, ky problem duket që vetvetiu do të zgjidhet. Përderisa komuniteti serb është më i zëshëm për të drejtat që i takojnë, ka edhe një ngritje të vullnetit për të punuar brenda sistemit. Si është e rregulluar ligjërisht kjo çështje? Një raport i Zyrës për Çështje të Komuniteteve argumenton që sistemi i kuotës duhet të bazohet në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 e cila përcakton që:

¹ Zyra për Çështje të Komuniteteve (Zyra e Kryeministrit). 2010. Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë brenda Shërbimit Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjeve Publike, http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/1-Policy_study_no1_FINAL.pdf; faqe. 105-114 (versioni anglisht).

Përfaqësimi i komunitetit pakicë në përbërjen e Shërbimit civil në të gjitha nivelet do të jetë proporcional me komunitetin pakicë në Kuvend. Sipas sistemit të ulëseve të garantuara për përfaqësim të komuniteteve jo-shumicë në Kuvend, përcaktuar me Nenin 64(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, secili komunitet duhet të përfaqësohet në Shërbimin Civil dhe Ndërmarrjet Publike si vijon:

1. Anëtarët e komunitetit shumicë – 83.33%, dhe
2. Anëtarët e komuniteteve jo-shumicë – 16.67%, shpërndarë si vijon:
 - a) Anëtarët e komunitetit serb – 8.33%;
 - b) Anëtarët e komunitetit boshnjak – 2.5%;
 - c) Anëtarët e komunitetit turk – 1.66%;
 - d) Anëtarët e komunitetit rom – 1.12%;
 - e) Anëtarët e komunitetit ashkali – 1.12% ²

Tashmë e pazbatueshme, Rregullorja e OKB-së 2011/19 ishte përdorur si bazë për të arritur në përfundimin që Kosova duhet të arrijë shkallën e 16% për përfaqësim të komuniteteve. Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhje të statusit, Kushtetuta e Kosovës, dhe Ligji për Komunitetet sot garantojnë përfaqësim të barabartë të komuniteteve në institucionet publike në të gjitha nivelet.

Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë proporcional në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu në veçanti shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin që qeveris administratën publike ³.

² Po aty, f. 329.

³ I njëjti tekst paraqitet edhe në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit dhe Kushtetutë. UNOSEK. 26 mars 2007. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit. Aneksi II. Neni 4. Pjesëmarrja e pakicave dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje; Paragrafi 4.4. http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf, f. 20 (version anglisht). Kushtetuta e Kosovës; Neni 61 – Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike.

Ligji për komunitetet nuk kontribuon shumë drejtë qartësimi të barazisë:

Personat që u përkasin komuniteteve kanë të drejtë në përfaqësim të barabartë në të gjitha nivelet në ndërmarrjet publike, institucionet publike, përfshirë sektorin e sigurisë, gjyqësorin, shërbimin e prokurorisë, agjencitë qeveritare që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë dhe shërbimet korrektuese, mbrojtjen, sigurinë dhe inteligjencën ⁴.

Pesha ligjore e dokumenteve të ndryshme ka shpënë në konfuzion dhe mospërputhje të pritjeve. Komuniteti serb shpesh e konsideron nivelin e 16% si më adekuatin. Është e qartë se nuk ka një mirëkuptim të përbashkët se cilin ligj duhet zbatuar. Një dokument që hedh më shumë dritë mbi përfaqësimin e kërkuar është Ligji për Shërbimin Civil:

Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë ⁵.

Kuota tani aplikohet tek të gjitha komunitetet jo-shumicë si një grup i vetëm. Kjo u krijon hapësirë autoriteteve që të përmbushin kuotën duke punësuar më shumë pjesëtarë të një komuniteti në dëm të komunitetit tjetër. Përfaqësimi serbë është i ulët dhe komuniteti serb shpesh është i

⁴ Kuvendi i Kosovës. 13 mars 2008. Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (Ligji No. 03/L-047).

http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_en.pdf.
Shih Nenin 9: Mundësitë ekonomike dhe shoqërore; paragraf 9.5, f.9.

⁵ Kuvendi i Kosovës. 13 maj 2010. Ligji për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës. Ligji Nr. 03/L-149.

<http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-149-eng.pdf>, f. 7. Neni 11.3.

përfaqësuar në numër më të vogël sesa komunitetet tjera. Tabela më poshtë paraqet kriteret sipas dokumenteve ligjore dhe nivelit të përfaqësimit.

Krahasimi i kriterëve dhe përfaqësimi aktual ⁶	Kriteri		Niveli Aktual		
	Rregullorja e OKB-së	Ligji mbi Shërbimin Civil	Niveli Qendror	Ndërmarrjet Publike ⁷	Niveli Komunal ⁸
Shqiptarë	83.30%	90%	92.02%	97.79%	95.17%
Serbë	8.33%	10%	5.08%	0.75%	3.06%
Komunitete tjera	8.34%		2.90%	1.46%	4.83%
Të gjitha komunitetet	16.67%		7.98%	2.21%	7.89%

Nivelet aktuale të përfaqësimit të pakicave janë nën 16% apo 10%. Niveli aktual i punësimit të pakicave në qeveri qëndron përafërsisht në 8%, përderisa ai i serbëve në 5%. Ka institucione si p.sh Aeroporti i Prishtinës që punëson shumë pak serbë (5 nga 644; 0.78%) ⁹.

Sistemi i kuotës mund të ketë mangësitë e veta, sidoqoftë, pa këtë sistem numrat do të ishin edhe më të vogël. Ka një

⁶ Zyra për Çështje të Komuniteteve (Zyra e Kryeministrit). 2010. Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë brenda Shërbimit Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjeve Publike, http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/1-Policy_study_no1_FINAL.pdf; f. 35-77 (versioni anglisht).

⁷ Të dhënat e paraqitura për ndërmarrjet publike reflektojnë numrin e serbëve të punësuar në Aeroportin e Prishtinës, Hekurudhat e Kosovës, Korporatën Energjetike të Kosovës dhe Postën dhe Telekomin e Kosovës.

⁸ Të dhënat e paraqitura në këtë raport reflektojnë numrin e të punësuarve në 26 komunat dhe nuk përfshijnë komunat e krijuara rishtazi.

⁹ Zyra për Çështje të Komuniteteve (Zyra e Kryeministrit). 2010. Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë brenda Shërbimit Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjeve Publike, http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/1-Policy_study_no1_FINAL.pdf; f. 76 (version anglisht).

mirëkuptim në rritje që përfaqësimi më i mirë do të kontribuoj në stabilizim politik dhe integrim të pakicave në të gjitha nivelet e sektorit publik në Kosovë. Përgjegjësia është e shumanshme dhe bie kryesisht tek autoritetet që duhet të sjellin vendimmarrjen më afër njerëzve. Komuniteti serb ka një përgjegjësi të madhe për të qenë më këmbëngulës dhe të përfshihet më shumë në debat jo vetëm për interesat e menjëhershme, por po ashtu edhe në prioritetet kombëtare.

Një çështje tjetër që i parandalon serbët për të përmbushur kriterin e punësimit në sektorin publik është mosnjohja e diplomave¹⁰. Përderisa diplomat e fituara në Beograd tani janë ligjërisht të pranuar, Kosova nuk i njeh diplomat e lëshuara nga institucionet paralele (p.sh. Universiteti i Prishtinës në Mitrovicë, apo shkollat e mesme në kreu Kosovën)¹¹. Çështja është duke u diskutuar nga Prishtina dhe Beogradi dhe është arritur një zgjidhje në parim, por duhet akoma kohë që të filloj implementimi. Disa struktura të komunave të reja i njohin kredencialet akademike të përmendura më lart, por kjo njohje duhet të standardizohet në tërë Kosovën.

Qytetarët e thjeshtë serbë ankohen që është e vështirë që të gjendet punë pa lidhje politike. Partitë politike kryesisht i punësojnë përkrahësit e tyre. Disa organizata të shoqërisë civile e kanë informuar PER-K se kanë qenë nën presion për të pranuar në punë ata kandidatë që janë anëtarë të partive të caktuara politike¹².

Të dhënat për pozitat e larta mungojnë. Është një fenomen mbarëbotëror që pakicat mungojnë në nivelet e larta udhëheqëse. Sidoqoftë, në Kosovë është e kundërta. Përderisa shumica e serbëve të thjeshtë i bojkotuan

¹⁰ Kovaqeviq, Mita. 11 mars 2011. Intervistë personale. Graçanicë, Kosovë.

¹¹ Basholli, Esma. 04 mars 2011. Intervistë personale. Graçanicë, Kosovë.

¹² Letra publike të dërguara nga Bojana Niqiq e Komunikimi për Zhvillim Shoqëror (CSD) and Mary Tomiq, Drejtoreshë e Administratës në komunën e Klllokotit.

institucionet, ata që u inkuadruan morën pozita të larta. Përderisa aeroporti ka serbë, një serb është në bord të këtij institucioni (nga 5 në total 5; 20%). Serbët janë të përfaqësuar në nivele të dukshme politike, por janë shumë të nën-përfaqësuar në pozita menaxheriale në kompanitë publike.

Në tërë Ballkanin, pozitat e larta kanë qenë historikisht të rezervuara për aktivistët politik të partive në pushtet, dhe Kosova nuk është përjashtim. Partitë politike në Kosovë janë të identifikuar me etnicitet (vetë-deklarimi është i paraparë me Kushtetutë për shkak të pretendimit për vendet e rezervuara/garantuara). Sigurimi i vendeve të punës është një prej aktiviteteve që partitë duhet ta kryejnë në mënyrë që të ruajnë përkrahjen politike

Nepotizmi i përhapur mund të jetë më i theksuar në mesin e serbëve për shkak të bojkotit të gjerë. Nepotizmi gjithashtu perceptohet ndryshe në mesin e serbëve për shkak se shihet si pjesëmarrje jopopullore, përderisa Beogradi i inkurajon në të kundërtën. Pjesëtarët e kualifikuar të komunitetit serb ndihen se aplikimi për pozita të larta është i kotë, pasi që këto ose janë të rezervuara për militantët partiakë, qoftë shqiptarë apo serbë. Si rezultat, punësimet janë të lidhura me etnicitet.

Përfaqësimi i duhur i pakicave nuk do të zgjidhet lehtë. Qeveria e Kosovës ka probleme me numrin e madh të shërbyesve civil të punësuar brenda institucioneve të saj. Numri dhe nivelet e pagave të shërbyesve civil dhe të punësuarve tjerë në këtë sektor kanë qenë shembujt e parë të mungesës së disiplinës buxhetore, gjë që ndikoj në ftohjen e marrëdhënieve me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Duke zbritur numrin e përgjithshëm të shërbyesve civil dhe filluar përdorimin e meritokracisë, Kosova në të njëjtën kohë duhet që të rrisë numrin e të punësuarve nga komunitetet pakicë në qeveri.

Varësia e tepërt në sektorin publik

Qeveria e Serbisë është punëdhënësi më i madh i serbëve të Kosovës që jetojnë në veri sikurse edhe të atyre që jetojnë në jug. Punëdhënësi i dytë më i madh është sektori privat, pasuar nga qeveria e Kosovës (kryesisht në nivelin komunal).

Rreth 40.000 njerëz (kryesisht serbë, por po ashtu edhe romë, goranë, etj) në Kosovë marrin një lloj përkrahje nga qeveria e Serbisë. Rreth 21.000 janë në listë të pagave dhe marrin së paku një pagë minimale ¹³. Duke pasur parasysh se vetëm pak më shumë se 100.000 serbë jetojnë në Kosovë, çdo i pesti e ka një rrogë dhe një i pestë tjetër merr një tjetër lloj të asistencës. Këta numra janë të mjaftueshëm për të përkrahur deri në 4/5 e komunitetit. 20 % i mbetur mbështetet në ndihmat e qeverisë së Kosovës dhe nga rrogat e komunave të reja.

Ka dallime të ndryshme në burimin e të ardhurave nga etniciteti. Një raport i rëndësishëm, edhe pse me të dhëna të vjetruara, nxjerrë një zbërthim të llojeve të burimeve nga të cilat varen krejt komunitetet. Përderisa serbët varen më shumë nga rrogat, pensionet, ndihmat sociale, kursimet dhe shitja e pronave, shqiptarët varen më shumë nga fitimet në biznes dhe qira, kredi, remitancat dhe ndihmat nga të afërmit/miqtë.

Të dhënat po ashtu sugjerojnë që serbët që marrin ndihma nga qeveria serbe kanë të hyra më të mëdha sesa kolegët e tyre shqiptarë. Një serb i Kosovës zakonisht merr një pagë prej 1,285 euro përderisa një shqiptar merr 1,051 euro ¹⁴.

Komuniteti serb nuk është i përfaqësuar mirë as në organizatat e biznesit në Kosovë. Asnjë kompani me pronarë serbë nuk është pjesë e Odës Ekonomike të Kosovës, dhe

¹³ Anonim. 12 prill 2011. Intervistë personale. Graçanicë, Kosovë.

¹⁴ Po aty. f. 30.

marrëdhëniet e tyre me ministritë relevante të linjës janë të dobëta.

Lloji i të hyrave i zbërthyer sipas etnicitetit ¹⁵	Pagat	Pensionet dhe ndihma sociale	Fitimi në biznes dhe qira	Huat	Remitancat dhe ndihmat nga të afërmit dhe miqtë	Kursimet dhe pronat e shitura
Shqiptarët e Kosovës	28%	5%	16%	18%	15%	7%
Serbët e Kosovës	48%	17%	9%	7%	1%	12%

Shpallja e pozitive të punës dhe mundësitë për subvencion të ofruara nga këto ministri nuk mbërrijnë te komuniteti serb pasi që ato publikohen shumë rrallë në mediat serbe. Shpesh është e vështirë për të gjetur të dhëna dhe ministria vendos kritere të larta për subvencione që janë më pak të aplikueshme te komuniteti serb. Dokumentet shpesh nuk gjenden në gjuhën serbe apo janë të përkthyer dobët.

Për më tepër, bizneset serbe vështirë që gjenden në regjistrat kosovare të biznesit. Ka nevojë për një regjistër të bizneseve serbe, pasi që nuk ka një bazë të të dhënave që përmban bizneset serbe dhe shërbimet që ato ofrojnë. Një bazë e tillë e të dhënave, do t'i ofronte bizneseve më shumë mundësi që të reklamojnë shërbimet e tyre, do të rriste qasjen e tyre në tregjet lokale dhe kombëtare, si dhe lehtësoj bashkëpunimin me biznese tjera. Mundësi të tilla do të lejonin bizneset serbe që të marrin pjesë në marrëveshje tregtare dhe të jenë të pranishme në panairët lokale dhe ndërkombëtare.

¹⁵ UNDP. 2004. Ngritja e Qytetarit: Sfidat dhe Mundësitë (Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosova 2004). f. 129. (versioni anglisht)

Pengesat në përfshirjen e sektorit privat

Kosova është drejtuar drejt një modeli perëndimor të qeverisjes me ekonomi të lirë të tregut. Një pjesëmarrje e duhur në sektorin publik dhe një aktivitet vibrant në sektorin privat janë të rëndësishme për mirëqenien e të gjitha komuniteteve, veçanërisht për rininë. Komunitetet që janë aktive në sektorin privat do të kenë një të ardhme të ndritur në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë.

Përderisa vendet e punës në sektorin publik janë të rëndësishme, numri i tyre ka të ngjarë të bie. Të ardhurat e larta nga pagat publike dhe numri i madh i njerëzve që varen nga ky sektor është një nga faktorët kryesorë që paraqet kërcënim për kompanitë private.

Komuniteti serb nuk ka qenë i përfshirë në zhvillimin e politikave privatizuese, apo në zbatimin e tyre. Shumë kompani që herët kanë punësuar serbë tashmë janë privatizuar, dhe pronarët e rinj nuk duhet që të përmbushin ndonjë kuotë për punësimin e pakicave siç është praktika në sektorin publik. Kompanitë private në komunitetet e shumëllojshme nuk punësojnë në mënyrë adekuate pjesëtarë të komuniteteve pakicë (p.sh. qendra për mjekësi fizikale dhe rehabilitim në komunën me shumicë serbe, Kllokot, nuk ka të punësuar asnjë serb.).

Një rast i 'suksesshëm' i lobimit të serbëve lokal ishte parandalimi i qendrës së skitarisë në Beograd. Dhjetëra serbë janë akoma të punësuar atje dhe përfitojnë nga shitja e tiketave pasi që INEX nuk i paguan ata rregullisht.

Arsyet prapa nën-përfaqësimit të serbëve në sektorin privat duhet të kërkohen në mesin e dy faktorëve kryesorë: (a) politizimit dhe varësisë së madhe në sektorin publik, dhe (b) mungesës së sigurisë dhe vizionit në aspektin afatgjatë. Përderisa e para zvogëlon sasinë e forcës së punës së tepruar të nevojshme për të nxitur një sektor konkurrues privat, e

dyta zvogëlon rrezikun që ndërmarrësit individual janë të gatshëm të ndërmarrin para se ata të vendosin që të investojnë kursimet e tyre në një biznes të rrezikshëm. PER-K shpesh ka dëgjuar argumentin që serbët janë me një këmbë në Kosovë e me një tjetër në Serbi, që tregon pasigurinë e tyre.

	Vlerësimet për popullsinë	Kredimarrësit	Madhësia mesatare e kredisë	Gjatësia mesatare e kredive
Shqiptarë	1,700,000	300,000 (18%)	5,605 Euro	4.5 vite
Serbë	120,000	11,000 (10%)	2,345 Euro	2.4 vite

Se serbët kanë qëndrim të vakët i serbëve perspektivës në biznes vërehet edhe kur të shikohen shifrat. Numri i serbëve që kërkojnë kredi është më i vogël sesa i shqiptarëve dhe ata marrin kredi më të vogla për një periudhë më të shkurtë kohore (shih figurën më lartë). Gjatë vitit 2010, Zyra e KEP-it në Graçanicë ka marrë 925 kërkesa për kredi, 65% e të cilave janë aprovuar. Kjo nënkupton se ky institucion ka marrë mesatarisht 2,8 kërkesa në ditë gjatë vitit 2010 ¹⁶.

Qeveria e Serbisë po ashtu ka ofruar kredi në Kosovën qendrore, edhe pse shumë pak serbë i kanë marrë ato. Disa intervista kanë treguar që këto kredi bazohen në atë që një person që kërkon kredi duhet që ta ketë një kompani private funksionale. Duke pasur parasysh që shumë pak kompani janë në funksion, numri i kredive të marra është shumë i vogël.

Mundësitë e punësimit për serbët në Kosovë vazhdojnë të mungojnë sikurse ka edhe shumë pak investime private në zonat me shumicë serbe në jug të Ibrit. Për shembull, dy bizneset më të mëdha në Graçanicë (qyteti më i madh serb pas Mitrovicës) nuk kanë më shumë se 27 punëtorë (shtatë

¹⁶ Miliqeviq, Nenad. 11 mars 2011. Intervistë private, Graçanicë, Kosovë.

(7) në dy (2) supermarketët tek Jovani dhe 20 në mishtoren Skurt). Pagat në dyqanet dhe bizneset në Graçanicë sillen nga 150 në 250 euro në muaj.

With regards to job creation in Kosovo, the predominance of Sa i përket krijimit të vendeve të punës, dominimi i sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) krijon një mjedis të pafavorshëm për komunitetin serb. Shumica e serbëve kanë punuar në kompani të mëdha shtetërore dhe mesatarisht ata janë më të moshuar sesa shqiptarët e Kosovës. Vetëpunësimi është më i pranishëm tek të rinjtë sesa tek të moshuarit. Shoqëruar me frikën e pasigurisë politike, shtytjet për të filluar një biznes të ri janë shumë të ulëta. Anketat e bëra me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme tregojnë që aftësitë e forcës punëtore nuk janë pengesa të mëdha për bizneset e tyre ¹⁷. Duke pasur parasysh faktin që shumica e ndërmarrjeve janë të angazhuara në fushë-veprimtari që kërkojnë aftësi të vogla atëherë kjo nuk është ndonjë befasi.

Kjo pjesë ilustron se si komuniteti serb vazhdon të mbështetet në sektorin publik dhe se si në shumë mënyra nuk kanë kaluar përmes një tranzicioni nga ekonomia e kontrolluar nga shteti në ekonomi të lirë. Përderisa vetë Serbia ka kaluar privatizimin, ajo ka mbajtur serbët e Kosovës në lista të pagave publike për shkak të frikës së migrimit dhe parandalimit të tyre për t'ju bashkangjitur institucioneve të Kosovës. Kjo politikë ka rezultuar me faktin që serbët e Kosovës të kenë rroga më të mëdha sesa në Serbi (dhe shumë më të mëdha se mesatarja në Kosovë). Është e vështirë që pagat prej 200 eurove të sektorit privat të garojnë me pagat prej 600 eurove të qeverisë për motrat

¹⁷ Banka Botërore. 2005. Të rinjtë në Kosovë. E qasshme në : http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Projects%20and%20Operations/20516174/YVG_Report_Donor_Government_Meeting_public.pdf.

medicinale (rreth 4.300 motra medicinale serbe në Kosovë marrin një pagë mujore mbi 600 euro)¹⁸.

Nuk është e çuditshme që serbët në tërë Kosovën tregohen më të sigurt me vende të punës në qeveri, që është diçka tipike për shoqëritë në tranzicion. Politizimi i serbëve të Kosovës i ka mbajtur ata të vërshuar me vende të punës në qeveri, kryesisht nga Serbia por me një numër në rritje edhe në qeveri të Kosovës. Kjo garë e përkohshme për të fituar zemrat dhe mendjet e tyre i ka penguar ata që të kalojnë nga tranzicioni në ekonomi të tregut, gjë që vetëm e ka shtyrë atë që duket të jetë e pashmangshme. Përfundimi i mosmarrëveshjeve sjellë lehtësim politik për komunitetin serb, por së bashku me të vijnë edhe shqetësimet ekonomike. Pagat e Beogradit duket të jenë të paqëndrueshme në aspektin afatgjatë, gjë që sjellë shqetësime tek serbët.

Para se serbët të rrezikojnë kursimet e tyre dhe të investojnë në projekte afatgjatë të zhvillimit, atyre u duhet një ndjenjë më e madhe e përfaqësimit, një zë përfaqësues në sektorin publik të Kosovës.

Pjesëmarrja, motivimi dhe identiteti kulturor

Papunësia mund të jetë shqetësimi kryesor për shumicën e serbëve, por të rinjtë serbë kanë edhe sfida të tjera. E vetmja qendër urbane dhe intelektuale për komunitetin serb mbetet veriu i Mitrovicës. Ekziston një nevojë e madhe për urbanizmin e qyteteve tjera siç janë Graçanica dhe Shtërpca.

Nën-përfaqësimi në masë të madhe është rezultat i politikës së Beogradit për të penguar serbët e Kosovës që t'i bashkëngjiten institucioneve sikurse dhe diskriminimi nga

¹⁸ Vecernje Novosti. 9 December 2008. Nema više duplih plat [Nuk ka më rroga të dyfishta]. <http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.69.html:227899-Nema-vise-duplih-plata>. (qasur për herë të fundit me 12 nëntor 2011). Autorë: B.R, B.B.

shumica. Serbët e Kosovës në jug të lumit Ibër zakonisht presin nga Beogradi për drejtim politik dhe si rezultat shumë serbë akoma nuk kanë besim tek liderët serbë të Kosovës që marrin pjesë në institucionet e Kosovës. Në të njëjtën kohë, pa presion nga komuniteti dhe me pak përkrahje të ekspertëve, politikanët serbë kanë paraqitur pak politika.

Komunikimi i dobët ndërmjet komunitetit serb në Kosovë dhe lidërshiptit të vetë ka dërguar në zhgënjim të serbëve të rinj. Mungesa e mbulimit adekuat të aktiviteteve të brendshme politike, shoqërore, ekonomike, kulturore dhe marketingut, paraqesin një sfidë tjetër madhore. Tabela më poshtë paraqet zberthimin etnik të indeksit të kapitalit social, të matur për here të fundit në vitin 2004.

Indeksi i kapitalit social ¹⁹ (në %)	Projektet e implementuara nga OJQ-të	Projekte të implementuara nga qeveria lokale	Kanë marrë pjesë në diskutime publike	Kanë marrë pjesë në iniciativa shoqërore	Kanë nënshkruar peticione	Kanë marrë pjesë në protesta publike	Indeksi i kapitalit social
Shqiptarët	1.80	0.60	7.50	7.10	6.90	23.30	65.06
Serbët	2.00	1.00	2.00	2.00	1.90	15.20	59.25

Mungesa e motivimit është një nga problemet më të mëdha tek të rinjtë serbë. Krahas problemeve të identifikuar më lartë, arsimiti i dobët dhe mungesa e një elite intelektuale proaktive kontribuon në mungesë të drejtimit. Serbët me aftësi të larta që marrin tituj universitar shohin pak

¹⁹ UNDP. 2004. Raporti i Zhvillimit Njerëzor (Tabela A22. Statistika për Pjesëmarrje dhe Indeksi i Kapitalit Social), f. 131.
<http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/KHDR2004.pdf> (qasur për here të fundit me 08 shkurt 2012).

perspektivë të punësimit. Prandaj, krijimi i një plani për motivim të të rinjve serbë që të mbesin në Kosovë pas diplomimit, mbetet një sfidë e madhe, por po ashtu edhe një mundësi.

Të rinjtë në Kosovë ndjehen të anashkaluar edhe për shkak të mungesës së mundësive për praktikim të sportit. Sukseset e ekipeve të sportit në Serbi, po shkaktojnë mungesën e mundësive për inkuadrim e serbëve në sportin kosovar. Klubi i volejbollit Partizani nga Lipjani, p.sh. është një ekip që garon në ligën e parë të Serbisë por lojërat si vendas i luan në Zubin Potok. Kjo ndikon negativisht në përpjekjet promovuese, pasi që nuk mund të joshën tifoz dhe si e tillë ndikon komunitetin në tërësi. Integrimi i këtij ekipi në sistemin e sportit kosovar është shumë i vështirë pasi që Kosova nuk është pjesë e garave sportive ndërkombëtare. Një ekip që ka garuar në ligën e basketbollit të Kosovës ka ndërprerë një gjë të tillë pas disa incidenteve dhe mospagesës së obligimeve financiare. Sidoqoftë, zhvillimi i klubeve të sportit, si dhe asociacioneve të ndryshme të sportit në Kosovën qendrore do të hapte mundësi të reja për serbët e Kosovës dhe do të ndihmonte në përfshirjen e tyre.

Mungesa e organizimeve kulturore dhe ruajtja e identitet kombëtar është problematike në Kosovë. Tek dhjetë vite pas luftës u luajtën shfaqje teatrale në Graçanicë dhe enklava tjera në Kosovë, përmes Javës së Kulturës të sponsorizuar nga donatorët. Ky organizim është ndjekur nga 30.000 njerëz, 70% e të cilëve kanë qenë të rinj dhe ka qenë ngjarja më e madhe e organizuar pas Vidovdanit, organizuar nga qeveria e Serbisë në tri vitet e fundit.

Shumë përfaqësues të organizatave të të rinjve kanë ngritur shqetësimet e tyre për mungesën e 'rol modeleve' të mira për të rinjtë serbë në Kosovë. Disa individë kanë pozita të larta por nuk kanë shkollim të duhur adekuat apo përvojë pune - këta individë janë 'rol-modele' negative që ndikojnë në ulke të motivimit dhe planifikim të karrierës për të rinjtë serbë.

‘Rol-modele’ pozitive duhet të inkurajohen dhe promovohen në komunitetin serbë sikurse edhe në krejt Kosovën.

Humbja e busullës

Disa liderë serbë shpesh e përsërisin që kanë mbetur pa elitë intelektuale dhe nuk mund të identifikojnë liderë që mund të zënë vendin e krijuar nga mungesa e Beogradit. Shumica e elitës intelektuale serbe në jug të Mitrovicës nuk janë banorë të përhershëm. Ata janë kryesisht doktorë dhe profesorë që me familjet e tyre jetojnë në Serbi, dhe punojnë intensivisht në Kosovë në periudha të shkurtra kohore. Udhëtimi i parandalon elitën intelektuale serbe që në mënyrë aktive të marrë pjesë në jetën politike dhe shoqërore në Kosovë. Për më tepër, pagat e larta nga qeveria e Serbisë janë faktori i vetëm që i mban këta profesionistë në Kosovë. Nëse Serbia i zvogëlon këto paga si rezultat i përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, do të kishte dorëheqje masive dhe mungesë të profesionistëve në këto institucione.

Në shumicën e rasteve, serbët e Kosovës nuk janë të mirë në gjuhët e huaja. Shkollat kanë filluar të japin anglisht, por niveli i avancuar i gjuhës angleze është akoma i ulët. Shqipja nuk mësohet në shkollat serbe dhe flitet vetëm nga një numër i vogël i serbëve të moshuar. Të rinjtë shqiptarë dhe serbë e konsiderojnë gjuhën tani si pengesë më të madhe sesa që ka qenë në mes të prindërve të tyre. Disa organizata të shoqërisë civile avokojnë për futjen e gjuhës shqipe në shkolla, por shumica e komunitetit e shohin këtë si kërcënim për komunitetin serbë në Kosovë dhe rininë e tij. Kjo ka filluar të ndryshojë dhe shumica e serbëve tani pajtohen që mësimi i gjuhës shqipe do të ishte përparësi.

Njohja e gjuhës shqipe nuk kërkohet në sektorin publik, por është e domosdoshme në sektorin privat. Për të rritur mundësitë e punësimit për të rinjtë serbë, PER-K

rekomandon që të subvencionohet mësimi i gjuhës shqipe për serbët e interesuar. Një sektor në rritje i shitjes me pakicë me tregtarë serbë do të ishte një mundësi e mirë për serbët me njohuri të gjuhës shqipe.

Arsimi dhe Migrimi

Sipas të dhënave të siguruara nga strukturat paralele serbe të arsimit dhe komuna e Graçanicës, janë mbi 4.000 nxënës të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovën qendrore dhe Graçanicë. Shkollat janë të stërmbushura dhe të vjetruara. Mungesa e infrastrukturës është e njëjtë në të gjitha zonat serbe në jug. Në zonat e mbipopulluara, nxënësit i ndjekin mësimet në tri ndërrime, përderisa fshatrat e vogla shohin zvogëlim të numrit dhe mbyllje të shkollave.

Komuniteti serb është i indinjuar me bllokimin politik sa i përket arsimit dhe shëndetësisë, gjë që ka penguar investimet në këta dy sektorë. Qeveria e Serbisë ka përqendruar vëmendjen e vetë në mbulimin e shpenzimeve të personelit, por nuk ka investuar në infrastrukturë shkollore. Donatorët kanë qëndruar larg zonave kundërthënëse të institucioneve paralele duke pritur një marrëveshje ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Edhe pse Plani i Ahtisaarit e lejon që komuniteti serb në Kosovës të përdorë planprogramin kombëtar serb, kjo marrëveshje ka mbetur peng i bashkëpunimit transparent në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Qeveria e Kosovës kërkon nga shkollat të regjistrohen në Ministrinë e Arsimit (MASHT) në mënyrë që të përfitojnë fonde.

Legjislacioni aktual parasheh që nëse një klasë ka më pak se katër (4) nxënës, këta nxënës duhet të transferohen në shkollën më të afërt me kapacitet më të madh. Shumë serbë e shohin këtë rregull si të pamjaftueshëm për fshatrat serbe

të vogla. Disa zona në fakt mund të kenë alternativa të pakta (p.sh. fëmijët e shkollës së Gorazhdecit duhet të udhëtojnë me dhjetëra kilometra për në shkollën më të afërt serbe).

Përderisa komuniteti serb është duke kaluar nëpër një tranzicion të vështirë politik, tranzicioni ekonomik i tij duket të jetë edhe më i vështirë. Të mësuar me shpenzime të mëdha publike, serbët tani ndjehen të kufizuar me nivelin e ulët të subvencioneve. Numri i mësuesve dhe doktorëve në Kosovë është reduktuar shumë për shkak të kufizimeve të FMN-së. Sistemi operues serb në Kosovë, mbulon vetëm 40% të personelit arsimor krahasuar me sistemin e atëhershëm jugosllav. Përveç kësaj, sistemet e arsimit të Kosovës dhe Serbisë janë të papërputhshme: shkollimi në Kosovë është i organizuar në 5 vite (e ulët fillore) +4 (fillore e lartë) +3-4 (gjimnaz), përderisa sistemi i Serbisë është 4+4+4 vite.

Është thelbësore për të gjitha palët e interesuara që të shtojnë përpjekjet e tyre për të zhvilluar dhe stabilizuar sistemin arsimor serbë në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare, institucionet e Kosovës dhe Serbia duhet të vazhdojnë rigjallërimin e sektorit të arsimit serb pasi që ai është një nga faktorët kryesorë që kontribuon në zhvillimin intelektual dhe human të serbëve në Kosovë. Një marrëveshje për të integruar sistemin paralel në atë të Kosovës sipas Planit të Ahtisaarit është brenda mundësive dhe duhet të bëhet prioritet.

Universiteti i Prishtinës në veri dhe ndërtimi i një kampusi universitar është një simbol i përkushtimit të Serbisë për të qëndruar atje. Themeluesit e Universitetit dëshirojnë ta shohin atë si një institucion modern dhe përparimtar, me lidhje të ngushta rajonale dhe me universitete Evropiane. Objektet e reja të këtij universitete janë shumë më të avancuara sesa universitete në qendra të mëdha si në Nish, Kragujevc dhe Novi Sad. Software i universitetit nuk është përditësuar dhe studentët ankohen shumë në administratë

dhe fakultet, jo-kompetencë dhe favorizime. Për çdo vit, Universiteti i Mitrovicës mirëpret përafërsisht 1.200 studentë të rinj nga zona të ndryshme të Kosovës dhe Serbisë. Një vlerësim i përafërt nga intervistat e bëra tregon që më pak se 1/6 e serbëve të jugut të Kosovës shkojnë në Serbi, asnjë nuk qëndron në Mitrovicë, përderisa shumica e tyre kthehen në shtëpi.

Ku studiojnë serbët e Kosovës?	Universiteti i Mitrovicës	Vranjë, Preshevë
	4,231 (prej 11.000 total) ²⁰	600

Kthimi apo mbajtja e rinisë?

Nga 50.000 njerëz që kanë shprehur gatishmërinë për t'u kthyer në Kosovë, jo më shumë se 20.000 mund të bëjnë një gjë të tillë. Burimet duhet të përqendrohen në mbajtjen e komunitetit që aktualisht jetonë këtu. Përqendrimi i tepërt në kthim, në ndërkohë mund të ketë për pasojë largimin e një numri më të madh të atyre që aktualisht jetojnë në Kosovë.

Ndërtimi i banesave kolektive në përgjithësi shihet si skemë e blerjes së votës dhe shpërblim për militantët partiak. Banesat dhe shtëpitë e ndërtuara nga qeveria e Serbisë ilegalisht janë okupuar nga individë të ndryshëm para se ato të përfundoheshin. Këto investime nuk kanë pasur rezultatet e synuara pasi që shumë të kthyer i kanë shitur pronat e tyre të reja dhe e kanë lëshuar Kosovën. Këto lloje të ndërtimeve inkurajojnë vetëm kthimin e të moshuarve dhe jo të rinjve, grave dhe fëmijëve.

²⁰ Sipas Infostud, rreth 11.000 studentë ndjekin Universitetin e Mitrovicës, prej të cilëve 4.231 janë nga Kosova, përfshirë serbë, boshnjakë, RAE dhe goranë. Infostud. 2008. Informata për studime – Në Universitetin e Prishtinës 1,364 brucosha, Gjendet në: www.prijemni.infostud.com/vesti/Na-Pristsinskom-univerzitetu-1.364-brucosa/59/6579/.

Graçanica është një shembull i një fshati të mbipopulluar i cili ka nevojë urgjente që të zhvillohet në një zonë urbane. Sipas disa të dhënave, 30.000 serbë jetojnë në Graçanicë dhe fshatrat që e rrethojnë atë (Lipjan, Obiliq, Prilluzhë, etj.), barabartë me madhësinë e tri komunave në veri. Ekziston një mendim i gjerë se përkrahja në strehim dhe ndërtimi i infrastrukturës që do të përqendrohej në rininë serbe në qendër të Kosovës do të prodhonte më shumë rezultate, krijonte besim të komunitetit serb në jug të Ibrit dhe do të kontribuonte në qëndrueshmërinë e këtij komuniteti si tërësi.

Krijimi i një mjedisi urban së bashku me të gjithë përbërësit tjerë (kultura, zbavitja, sportet, jeta e natës) është thelbësore në mbajtjen e të rinjve serbë. Ka një nevojë të madhe për të koncentruar shërbimet në Graçanicë e cila duhet të shndërrohet në një zonë të re urbane ku serbët nga rajoni i Anamoravës dhe pjesë tjera të Kosovës mund të mblidhen së bashku. Prishtina mund të shoh interes në fuqizimin e Graçanicës si zonë urbane kështu që një lidhshmëri politike më konstruktive mund të shërbejë si alternativë kundrejt lidhshmërisë radikale në Mitrovicë.

Që nga viti 2004, komuniteti serb është stabilizuar dhe ka pak indikacione për tendencë të mëdha për migrim. Komuniteti serb në Kosovë ka një shkallë të lindshmërisë më të lartë sesa serbët në Serbi, edhe pse më të ulët sesa mesatarja e shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu ka një rritje të projekteve të ndërtimit, një tregues shtesë që komuniteti serb ka qëllim që të mbes në Kosovë. Megjithatë duke pasur parasysh lëvizjet masive të serbëve nga zonat urbane në enklavat serbe, niveli i ndërtimit nuk ka qenë i mjaftueshëm për të krijuar një mjedis urban adekuat.

Pavarësisht një rënijeje të përkohshme të shkallës së lindjeve në vitin 2004 (që vazhdoi deri në vitin 2006), e njëjta ka shënuar rritje graduale. Zyrtarë nga Spitali Simonida në Graçanicë tregojnë që shkalla e lindshmërisë tek serbët ka

arritur një shifër rekord prej 465 lindjesh gjatë vitit 2010, që reflekton rritjen e komunitetit serb në Kosovën qendrore (serbët tjerë përdorin objekte tjera alternative).

Avantazhi krahasues i serbëve të Kosovës

Komuniteti serb në Kosovë posedon numër të madh të pronës private në formë të tokës bujqësore. Përderisa mesatarja e pronarëve të tokave në Kosovë është dy herë më e vogël sesa në BE, një serb mesatar ka 3-4 herë më shumë tokë sesa një shqiptar mesatar²¹. Kjo tokë nuk është përdorur në kapacitetet e saj të plota dhe mund të paraqesë mundësi për bujqësi organike dhe në shkallë të gjerë. Fshatrat serbe zakonisht kanë infrastrukturë më të mirë pasi që në përgjithësi janë të lidhur në ujësjellës dhe kanalizim si dhe janë të vendosura afër arterieve të rrugëve kryesore. Duke pasur më pak nevojë për investim, komunat me shumicë serbe mund të aplikojnë taksa më të vogla për të tërhequr bizneset.

Pavarësisht parcelave të mëdha, komuniteti serb mund të mos ketë forcën punëtore të nevojshme për t'i punuar ato. Qeveria qendrore duhet të shohë interes në bujqësinë në shkallë të gjerë për disa arsye: (a) të punësojë me mijëra të papunë serbë dhe shqiptarë, dhe (b) të zëvendësoj shumicën e importit të mallrave. Rritja e çmimeve globale të ushqimit duhet t'u interesojë investitorëve privat, veçanërisht tani kur Kosova i ka rritur subvencionet për bujqësinë.

Duke pasur parasysh lokacionin dhe ujin mineral natyral, komunat siç janë Shtërpca dhe Kllokoti kanë potencialin për të qenë qendra të turizmit mjekësor. Komuna e Shtërpçës ka potencialin që të jetë një qendër e turizmit përgjatë gjithë vitit. Shërbimet shëndetësore mund të jenë një burim

²¹ Llogaritje të PERK-K bazuar në tokën e punueshme dhe të dhënat demografike komunale.

potencial për avantazhin krahasues pasi që një profil i tillë konsiderohet si një pasuri e madhe për komunitetin. Shumica dërrmuese e individëve të kualifikuar dhe të arsimuar janë punësuar tashmë nga strukturat paralele serbe, por një numër i tyre mund të pushohen nga puna nga administrata e Beogradit në pritje të një marrëveshje me Prishtinën. Investimet në shërbimet shëndetësore private mund të absorbojnë disa nga ta. Këto mund të tërheqin një numër të shqiptarëve që aktualisht përdorin Shkupin dhe kështu do të ndihmonin që paraja të mbetet brenda vendit.

Rekomandimet

Një numër gjithnjë e më i madh i serbëve janë duke i ndërtuar dhe riparuar shtëpitë e tyre, një shenjë e përkushtimit të tyre për të qëndruar në Kosovë. Për të inkurajuar entuziazmin për qëndrim, qeveria qendrore dhe komunat e reja duhet të punojnë me komunitetin serb për të ripërtërirë dhe përkrahur këtë optimizëm. Rekomandimet në vijim janë të këshillueshme për akterët në vijim:

Qeverinë e Kosovës:

1. Vendos një cak për të rritur përfaqësimin e pakicave në sektorin publik me 1% në vit dhe një cak të veçantë për komunitetin serb. Qeveria e Kosovës duhet të mas nivelin aktual dhe të caktoj një cak për të arritur nivelet e kërkuara brenda 5-6 viteve. Ky plan veprimi kërkon një strategji gjithëpërfshirëse dhe të shumanshme.
2. Identifikoj avantazhin krahasues të serbëve të Kosovës. Për shkak të disponueshmërisë së tokës, Ministria e Bujqësisë duhet të investoj në bujqësinë në shkallë të gjerë përmes kredive të buta, të cilat do të punësonin serbët dhe shqiptarët dhe do të përmirësonin bilancin tregtar të Kosovës.
3. Mësimi i gjuhës shqipe duhet të subvencionohet nga qeveria dhe donatorët për serbët e interesuar.

Komunat me shumicë serbe:

4. Të bëhet prioritet urbanizimi i zonave të mëdha dhe të investohet në kulturë dhe sport. Komuna e Graçanicës duhet të bëjë plane afatgjate për të shërbyer si qendër urbane e një zone më të gjerë. Duhet të analizohen arsyet e udhëtimit të serbëve të Kosovës në Mitrovicë dhe këto shërbime gradualisht duhet të zëvendësohen me shërbime lokale.

5. Të nxiten kompanitë private në zona të ndryshme që të punësojnë anëtarë të komuniteteve në nivelin e duhur. Autoritetet duhet të fillojnë një program praktik për të rinjtë serbë në institucionet publike dhe kompanitë private ku më pastaj do të mund edhe të punësoheshin në rast të pozitave të hapura. Trajnime do të mund të organizoheshin për të rritur më shpejtë aftësitë. Duhet të ndërmerren fushata rekrutuese për trajnim të serbëve, si dhe programe promovuese dhe të përkrahen berza të punësimit për punëmarrës me perspektiv.

Qeveria e Serbisë:

6. Zvogëloj varësinë në sektorin publik. Qeveria e Serbisë duhet që gradualisht të zvogëloj varësinë e komunitetit serb nga pagat e saj dhe të kanalizoj burimet në zhvillimin e sektorit privat përmes kredive të favorshme.
7. Të bëhet prioritet tranzicioni i shëndetësisë dhe arsimit në Kosovë. Qeveria serbe duhet të asistoj në shëndetësi dhe arsim transparent për t'a lehtësuar pranimin e saj në Kosovë si pjesë e Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin.

Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë

Rëndësia e Graçanicës dhe Shtërpcës

Prishtinë, Maj 2012

Përmbajtja

Përmbledhje, 35

Hyrje, 38

Nga ambienti urban në atë rural dhe anasjelltas, 41

Pjekja e kushteve dhe koha e duhur, 43

Një balancë e re dhe besim kolektiv, 44

Ofrimi i shërbimeve më afër shtëpisë, 45

Qendrat urbane në dispozicion të serbëve të Kosovës, 48

Përfundime, 56

Rekomandime, 60

Përmbledhje

Komuniteti serb ka filluar të përqendrohet nga nevojat akute tek perspektiva afatgjata. Komunitat e reja kanë sjellë siguri demografike përdërisa brengat e sigurisë janë zëvendësuar me mungesë të vendeve të punës. Procesi i kthimit duket se tashmë është konsumuar dhe tani vëmendja duhet të kthehet tek parandalimi i migrimit nga zonat rurale në ato urbane. Shumë njerëz mund të pyesin se pse duhet të parandalojmë diçka që njëkohësisht është trend global, njerëz përgjatë botës migrojnë drejt qyteteve. Migrimi paraqet një kërcënim të ngadalshëm për serbët e enklavizuar për të cilët zona më e afërt urbane e banuar me serbë mund të mos jetë fare në Kosovë, por në Serbi.

Përdërisa ky lloj i migrimit nuk është specifik për Kosovë, janë disa faktorë unik që e bëjnë këtë trend në veçanti më shqetësues. Nëse Kosova është e përkushtuar për të mbajtur popullatën e saj serbe, qeveria duhet të zhvillojë zona urbane serbe brenda kufijve të vetë.

Humbja e kontrollit të qyteteve të mëdha urbane ka qenë një përvojë traumatike për serbët, që ka shkaktuar humbje të elitës intelektuale duke prishur kështu strukturën shoqërore të komunitetit.

Një mënyrë me të cilën qeveria e Kosovës mund të ulë trendin e migrimit është ndihmesa ndaj komunitetit serb për të ndërtuar besim tek mjediset urbane të Kosovës. Nga një perspektivë gjeografike dhe logjike, kjo iniciativë do të kishte rezultatet më të mira nëse këto zona urbane do të zhvilloheshin sa më afër pjesëve ku aktualisht jetojnë serbët. Zhvillimet urbane qendrore paraqesin një mundësi shtesë për t'u shoqëruar me shqiptarët dhe komunitetet tjera, si dhe për të ndihmuar vetë komunitetin serb në zhvillimin e ndjenjës së stabilitetit pa frikë të humbjes së identitetit të tyre kolektiv.

Nga perspektiva demografike, dy grupet që do të përfitonin më së shumti nga ky zhvillim urban janë rinia serbe e cila është e gatshme për t'i lënë fshatrat drejt qyteteve të mëdha por dhe gjenerata më e vjetër të cilët janë rritur në qytete por më pastaj janë zhvendosur në fshatra.

Për shkak të lokacionit të tyre qendror, Graçanica dhe Shtërpca paraqesin opsionet më të mira për zhvillim urban, pasi që ato pothuajse se shërbejnë si qendra të komunitetit për shumicën serbe që gravitojnë rreth tyre.

Ky punim shqyrton mundësitë reale që këto dy qyteza të shndërrohen në qendra urbane, aq shumë të nevojshme për komunitetin serb. Madhësia e vogël e disa komunave të reja paraqet një pengesë por përvoja evropiane tregon se ka shembuj të shumtë ku fshatrat rurale janë zhvilluar në mjedise pjesërisht urbane. Zgjidhja duhet gjetur në një kombinim politikash të arsimit, planifikimit mjedisor dhe transportit publik efikas.

Sot Prishtina shërben vetëm si një destinacion për punë dhe shitblerje, megjithatë ajo ka potencial për t'u bërë më tërheqëse me kalimin e kohës. Edhe pse është një komunë tjetër, afërsia e Graçanicës me Prishtinën do të shpie në një komunikim dhe bashkëpunim të shtuar ndërmjet komuniteteve shqiptare dhe serbe. Në shumë mënyra, Graçanica do të mund të funksiononte si një lagje e fuqishme me shumicë serbe brenda kryeqytetit në zgjerim e sipër.

Në të njëjtën kohë, autoritetet e Kosovës kanë shumë arsye për të parë përfitime në transformimin e Graçanicës në një zonë urbane. Prishtina duhet të shohë përfitime potenciale financiare dhe politike, duke shndërruar serbët e Kosovës në qytetarë më lojal dhe zvogëluar ndikimin e Beogradit. Prishtina mund të tërheq më shumë serbë me sport, zbavitje dhe ngjarje kulturore të mëdha. Graçanica mund të tërheqë më shumë me arsim, kujdes shëndetësor sekondar dhe

zbavitje. Shtërpca mund të ofrojë më shumë vende pune dhe sport.

Hyrje

Një dekadë pas konfliktit, serbët e Kosovës vazhdojnë të ballafaqohen me një “mentalitet enklave”. Të gjitha palët e interesuara në Kosovë duhet të ndihmojnë këtë komunitet që të tejkalojë një lokalizim të tillë për një përfitim më të madh nga pjesëmarrja në shoqërinë kosovare. Pjesë e këtij tejkalimi do të vjen nga rritja e besimit në qendrat urbane si Graçanica dhe Shtërpca. Një vizion për të ardhmen e Kosovës është një popullatë serbe që mund të kërkojë shërbime për shëndetësi, arsim dhe kulturë në Graçanicë, sport dhe punë sezonale në Shtërpce dhe Gjilan e Prishtinë për shopping dhe argëtim.

Për të kthyer Shtërpcën dhe Graçanicën në dy qendra urbane kryesore për serbët e Kosovës ka edhe përfitime edhe sfida. Edhe pse çështjet elementare siç janë siguria, uji, edukimi fillor, mbledhja e mbeturinave dhe kanalizimi në masë të madhe janë rregulluar, çështje ditore si transporti publik, sporti, kultura, shëndeti sekondar, madje edhe shoppingu akoma nuk janë adresuar plotësisht.

Duke pasur parasysh që komunat e vogla nën 5.000 banorë (siç janë Ranillugu apo Parteshi) nuk i kanë kapacitetet për të ofruar më shumë sesa shërbimet themelore, sigurimi i qasjes për shërbime të avancuara në qendra të ndryshme të fshatrave të vogla është thelbësore. Komunat e Graçanicës dhe Shtërpcës nuk janë larg nga nocioni i një qendre urbane, të cilat mund të akomodojnë shumicën e elitës së serbëve të Kosovës. Këto dy zona munden pjesërisht që të mbushin zbrazësinë e cila aktualisht është duke u plotësuar në Vranjë. Përderisa ka pak gjasa që Graçanica apo Shtërpca do të zëvendësonin plotësisht shërbimet që i ofrojnë qytetet e mëdha në jug të Serbisë, zhvillimi i tyre do të do t'u mundësonte serbëve të Kosovës që të bëhen më pak të varur

nga qytetet serbe dhe të zhvillojnë një lojalitet më të lartë ndaj Kosovës.


Përqendrimi në jug të Kosovës

Ky punim përqendrohet në komunitetet serbe në qendër dhe jug të Kosovës. Edhe pse është e populluar nga vetëm një e treta (1/3) e serbëve të Kosovës, veriu i Kosovës ka tërhequr vëmendje më të madhe gjeo-strategjike sesa që do të duhej duke pasur parasysh madhësinë saj. Si shpërblim i drejtpërdrejtë për agresivitet, veriu tërheq më shumë fonde për arsim, shëndetësi, kulturë apo edhe sport dhe atë jo vetëm nga Serbia por edhe nga shumë donatorë ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, serbët në jug gradualisht janë më të gatshëm për të marrë pjesë në politikën kosovare dhe që të përfitojnë më shumë.

Veriu i Kosovës ndjehet i sigurt në numër dhe ofron mjaft shërbime për qëndrueshmëri afatgjate të komunitetit. Varësisht nga zhvillimet politike, Mitrovica mund të shërbejë si një qendër intelektuale dhe e fuqisë për serbët e Kosovës, por përderisa ky rol nuk ndahet me Graçanicën, serbët e jugut nuk do të marrin shërbimet përkatëse. Nuk është në interes të askujt që të krijojë dy komunitete serbe dhe ky punim nuk rekomandon një gjë të tillë. Megjithatë, në mungesë të një Graçanice urbane, shumë serbë që jetojnë në Anamoravë do të vazhdojnë të shikojnë kah Serbia në vend se të kontribuojnë në qendra urbane më afër shtëpive të tyre.

Ky punim shfrytëzon të dhëna të mbledhura nga institucione lokale dhe qendrore, sikurse edhe raporte nga organizata lokale dhe ndërkombëtare. Për të matur integrimin, PER-K ka përdorur informata të dorës së parë të siguruara përmes intervistave me palët të interesuara në terren. Zyrtarë komunal, shoqëria civile, media dhe qytetarë kanë qenë pjesë e intervistimit. Për më tepër, PER-K ka përgatitur një pyetësor të shkurtër për të vlerësuar nevojat për udhëtim.

Ku udhëtojnë më së shumti serbët e Anamoravës?



Rreth 150 serbë të rajonit të Gjilanit janë intervistuar për të mbledhur informata se për çfarë shërbimesh ata udhëtojnë. Një e treta e të intervistuarve kanë qenë mbi 41 vjeç, pak më shumë se një e treta nën 31 dhe më pak se një e treta ndërmjet 30 dhe 40. Rreth 43% e të anketuarve kanë qenë femra.

Nga ambienti urban në atë rural dhe anasjelltas

Para vitit 1999, komuniteti serb ka qenë kryesisht i vendosur në qendra urbane. Gjatë luftës dhe pas saj, shumë serb ikën në Serbi apo gjetën siguri në fshatrat përreth. Migrimi i serbëve në zonat rurale ka ndikuar në besimin e tyre dhe ka ngritur skepticizmin rreth fuqisë së tyre politike dhe ekonomike.

Kjo lëvizje e komunitetit serb nga zonat rurale dhe urbane ka ndikuar më së shumti në sektorin e arsimit. Fshatrat e vogla përballesh me ulje të numrit të nxënësve dhe mbyllje të klasëve. Studentët po shpërngulen në zonat urbane për mundësi më të mëdha të edukimit, apo kur ekzistojnë mundësitë financiare largohen edhe jashtë vendit.

Megjithëse ka disa karakteristika të ngjashme me ato të cekura më lartë, Graçanica është një përjashtim. Në këtë komunë, numri i nxënësve në shkollimin fillor dhe të mesëm është rritur dhe qyteza është e vetmja që përballet me mungesë të hapësirës së klasave.

Në shumë zona serbe ka mungesë të transportit publik efektiv, qasje të kufizuar në arsimin e lartë dhe mundësi të pakta për kulturë dhe argëtim. Politikanët në shumë raste pretendojnë se qytetarët e tyre kanë një këmbë në Kosovë dhe tjetrën në Serbi – jetojnë në Kosovë por varen nga Serbia për shërbimet kryesore. Kjo dilemë paraqet një rreth

vicioz ku komuniteti nuk planifikon dhe nuk investon në të ardhmen e tyre. Disa në besojnë se kanë një të ardhme këtu.

Me rritjen besimit në mes të dy komuniteteve, mund të imagjinohet që serbët të ndjehen më rehat për të plotësuar nevojat e tyre në qytetet me shumicë shqiptare. Në ndërkohë, komuniteti serb do të vazhdojë të shpërngulet drejt zonave urbane ku flitet gjuha serbe. Edhe në aspektin afatgjatë, me gjasë serbët do të vazhdojnë të plotësojnë nevojat e tyre specifike kulturore aty gjuha serbe është në përdorim të gjerë.

Për shërbimet që nuk i ofrojnë komunat e tyre, serbët nga jugu i Kosovës vazhdojnë të kërkojnë shërbime në Vranjë e në një masë edhe në Mitrovicë. Komunat me shumicë serbe në Kosovë si Graçanica dhe Shtërpca duhet të zgjerojnë gamën e shërbimeve që ofrojnë dhe të ngritin aktivitetin ekonomik në mënyrë që të mund të ofrojnë alternativë të besueshme të shërbimeve.

Në kohën që komunat rrisin kapacitetet e tyre, është me rëndësi të vlerësohet se çfarë shërbimet të tjera mund të ofrojnë ato, që të plotësojnë nevojat e qytetarëve të tyre sa më afër shtëpisë. Komunat e themeluara rishtazi si Ranillugu, Kllokoti dhe Parteshi, për shembull kanë një rrugë të gjatë për të rritur ofertën e shërbimeve cilësore. Në Ranillug, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë investime kapitale në vlerë prej 230.000 EUR, përdërisa në Partesh ka investuar rreth një milion euro në projekte infrastrukturore. Këto komuna kanë shënuar progres në mbledhjen e taksave, sidoqoftë, asnjë nga ato nuk ka kapacitete për tu shndërruar në qendër urbane si Graçanica apo Shtërpca. Disa madje e vënë në pikëpyetje nëse këto komuna do të jenë të qëndrueshme në aspektin afatgjatë.

Ka shumë kufizime në atë se çfarë mund të ofrojë një fshat i vogël dhe serbët do të vazhdojnë të udhëtojnë në zona të

tjera për shërbime të ndryshme. Megjithatë, është ilustruese dhe shpjeguese të shihet se ku dhe sa shpesh udhëtojnë ata.

Pjekja e kushteve dhe koha e duhur

Plani i Ahtisarit ka paraparë krijimin e komunave të reja që do të sillte qeverisjen më afër qytetarëve të zakonshëm dhe do të rriste rolin e këtyre të fundit në proceset vendimmarrëse në çështje më të rëndësishme se sa thjesht ato të përditshme. Në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës , në fund të vitit 2009 u mbajtën zgjedhjet lokale në tri komuna me shumicë serbe: Kllokot, Graçanicë dhe Ranillug. Zgjedhjet në Novobërdë u mbajtën duke u bazuar në zgjerimin e territorit të kësaj komune. Ndërsa, në mes të vitit 2010, zgjedhjet u mbajtën në Partesh, ku dalja ishte 65% (në krahasim me komunat e tjera ku ishte vetëm 20%).

Këto zgjedhje u konsideruan si sukses ngase ato ndikuan në ngritjen e komunave të reja si pjesë shumë e rëndësishme e procesit të decentralizimit. Komunat e reja shpejt filluan të themelojnë kuvendet komunale, dhe të angazhojnë personel ekzekutiv të aftë për të hartuar dhe aprovuar strategji për zhvillimin komunal. Megjithëse u deshën vite, ato tani janë plotësisht të pavarura nga komunat “amë” nga të cilat janë shkëputur.

Që nga deklarimi i pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, politika e Beogradit ka qenë kryesisht e kufizuar në inkurajimin e serbëve që të bojkotojnë institucionet e Kosovës. Beogradi ka investuar shumë në Kosovë, veçanërisht në veri. Politika e bojkotit ka qenë e suksesshme ne veri, por më pak e suksesshme në pjesët e tjera të vendit. Shumë serbë kanë ndjekur këshillën e Beogradit për të mos bashkëpunuar me institucionet e Kosovës. Kundërshtimet agresive të serbëve në administratën paralele po sfidojnë dhe dobësojnë komunat e reja.

Por, shumë serbë nuk e kanë marr parasysh strategjinë e Beogradit dhe kanë filluar të angazhohen në institucionet e Kosovës për të mirën e tyre. Komunitat e reja me mençuri kanë vërejtur që në komunitetin serb është më së miri që vet serbët të vendosin për çështjet që i preokupojnë ata.

Një balancë e re dhe besim kolektiv

Përmes decentralizimit u krijuan komunitat e reja me shumicë serbe në jug të Kosovës. Pikërisht në këto komuna, ku serbët me të vërtetë ndjejnë që ata e përbëjnë shumicën, dalja në zgjedhje është rritur. Konsolidimi i decentralizimit e ka vendosur barrën në komuna për të ofruar mundësi më të mira ekonomike dhe shërbime publike më efektive. Komuniteti serb ndjehet më pak i izoluar dhe po ashtu më i integruar në shoqërinë kosovare.

Bojkotimi i institucioneve të Kosovës dhe braktisja e qyteteve të mëdha në fshatra ka reflektuar në kapacitet e komunitetit serb për t'i dalë zot vetvetes. Beogradi nuk ka mundur të flasë në emër të tyre apo të avokojë për ta. Për të qenë në gjendje të bëjë këtë, Beogradi do të duhet të njihte autoritetin e Kosovës, gjë që shteti serb nuk ka vullnet ta bëjë.

Politika e Serbisë e ka vështirësuar konsolidimin e Kosovës por nuk i ka sjellë përfitime komunitetit lokal serb. Fushata e Beogradit për ta paraqitur Prishtinën si një agresor i ka dekurajuar serbët për shfrytëzim të shërbimeve që u takojnë, gjë që atyre u ka sjellë dëm. Kjo nuk do të thotë që Prishtina i mirëpret serbët krahë-hapur, por sjellja e Prishtinës është shumë larg nga ambienti armiqësor që portretizohet në mediat serbe. Komuniteti serb në Kosovë është në një situatë paradoksale ngase nuk i shfrytëzon sa duhet komunitat e mëdha të Kosovës, mirëpo as nuk ka zhvilluar shërbime ekuivalente në hapësirat ku jeton.

Komuniteti serb ka filluar të zhvillojë ndjenjën e pronësisë për komunat e veta. Megjithatë, ende mbesin tri mangësi (a) pronësia e përbashkët për prioritetet e përgjithshme të Kosovës; (b) qeverisja e mirë që mundëson përfshirje më të gjerë në çështjet komunale; dhe (c) një mjedis urban që krijon ndjenjën e dinjitetit dhe komfortit që vie si rezultat i sigurisë demografike në aspektin afatgjatë.

Ofrimi i shërbimeve më afër shtëpisë

Pse shkojnë serbët e Kosovës në Serbi?

Shërbimet që nevojiten më së shpeshti përbëjnë arsyen kryesore se pse serbët e Kosovës udhëtojnë në Serbi. Rreth 16% e serbëve të Kosovës udhëtojnë në Serbi së paku një herë në javë, përderisa më shumë se gjysma udhëtojnë në Serbi së paku një herë në muaj. Shpeshësia e udhëtimit të tyre, rritja e çmimeve të derivateve dhe lartësia e pagesës për sigurim të veturës tregojnë që një shumë e madhe e të ardhurave të serbëve të zakonshëm shpenzohet për të udhëtuar nga Kosova në Serbi.

Është me rëndësi të shikohen arsyet e udhëtimit për në Serbi. Një e pesta e serbëve të Kosovës udhëtojnë në Serbi për shopping (23%), për të vazhduar me një të pestën tjetër që udhëton për qëllime shëndetësore. Vizitimi i familjarëve dhe miqve renditet mesatarisht në 18%, pasuar nga kategoritë që udhëtojnë për argëtim, arsimim, kulturë dhe sport.


Zvogëlimi i numrit të serbëve që kanë nevojë udhëtojnë në distanca të largëta për shërbime bazike duhet të krijojë hapësirë për t'i përdorur këto burime për qëllime të tjera, një objektivi që duhet të shkojë për shtati edhe qeverisë së Kosovës. Rënia e numrit që udhëtojnë jashtë vendit, do të ruante një shumë të madhe, do të lidhte serbët e Kosovës

më shumë me Prishtinën dhe do të zvogëlonin varësinë nga Beogradi.

Sa shpesh udhëtoni në Serbi?



Qëllimi i udhëtimeve në Serbi?




Pse udhëtojnë serbët për në Vranjë?

Destinacioni më i shpeshtë në Serbi është Vranja. Së paku 19% udhëtojnë në Vranjë çdo javë, përderisa afër gjysma udhëtojnë një herë në muaj. Vetëm një e treta e serbëve të anketuar thonë që udhëtojnë në Vranjë shumë rrallë. Është me rëndësi që rreth 10% shkojnë në Vranjë disa herë gjatë javës, që mund të shpjegohet nga disa lloje të udhëtimit, përfshirë edhe administratën paralele.


Krahasimi i frekuencës së udhëtimeve për në Vranjë me pjesët e tjera të Serbisë jep rezultate befasuese. Vetëm 6% e të anketuarve udhëtojnë përtej Vranjës në baza mujore.

Një e treta e respondentëve udhëtojnë në Vranjë për të marrë dokumentet, përcjellë nga ata që shkojnë për të blerë (21%). Çmimet më të ulëta të ushqimit dhe shërbimeve mjekësore si dhe distanca e shkurtër, janë arsyet kryesore që e bën Vranjën destinacion kryesor.


Sa shpesh udhëtoni në Vranjë?



Qëllimi i udhëtimeve në Vranjë?



Pak shkojnë përtej Vranjës



Nuk ka ndonjë arsye pse Kosova nuk do të mund të ofrojë shumicën e shërbimeve që ofrohen në Vranjë. Përveç

dokumenteve serbe dhe vizitave familjare, shërbimet si blerjet, shëndetësia dhe argëtimi lehtë mund të ofrohen edhe në Kosovë.


Qendrat urbane në dispozicion të serbëve të Kosovës

Mbivlerësimi i Mitrovicës


Pavarësisht afërsisë dhe përshtypjes se Mitrovica është e vetmja “qendër urbane” për serbët e Kosovës, shumica e serbëve të Kosovës juglindore e vizitojnë Vranjën shumë më shpesh se sa Mitrovicën.

Afërsisht 11% e serbëve udhëtojnë në Mitrovicë së paku një herë në javë dhe 15% së paku një herë në muaj. Një e treta shumë rrallë shkojnë në veri. Është me rëndësi të ceket se hulumtimi është realizuar para vendosjes së barrikadave në mes të vitit 2011, prandaj udhëtimi atje mund të ketë pësuar rënie edhe më shumë.

Sa shpesh udhëtoni në Mitrovicë?



Qëllimi i udhëtimeve në Mitrovicë?



Nuk është e çuditshme që 37% e serbëve udhëtojnë në Mitrovicë për qëllime shëndetësore. I vetmi institucion i shëndetësisë dytësore funksionon në Mitrovicë me një personel prej afër 900 personash (shumë më shumë se sa që nevojiten për zonën rreth Mitrovicës). Përqindja e serbëve që udhëtojnë në Mitrovicë për këtë qëllim do të bie në momentin kur qendrat e mjekësisë familjare do të bëhen funksionale edhe në Graçanicë dhe Shtërpcë siç parashihet me Propozimin Gjithëpërfshirës për Statusin.

Arsimi do të vazhdojë të shërbejë si arsye gravitimi në veri, megjithëse donatorët dhe institucionet e nivelit qendror duhet të inkurajohen që të investojnë në arsimimin e lartë dhe në trajnimet profesionale për bujqësi dhe turizëm në Graçanicë dhe në Shtërpcë.


Mungesa e sundimit të ligjit ka mundësuar që në Mitrovicë çmimet të jenë të lira, gjë që mund të ndryshojë kur të vendoset sundimi i ligjit edhe atje. Në përgjithësi, tërheqja që ka Mitrovica për serbët do të zbehet. Autoritetet e Kosovës duhet të punojnë për së afërmi me partitë politike serbe që marrin pjesë në jetën institucionale në mënyrë që të ulët rëndësia e Mitrovicës, kryesisht duke zëvendësuar ofrimin e këtyre shërbimeve nga institucionet kosovare. Ato duhet të fokusohen në mënyrë të veçantë në shëndetësi, qendra tregtare, punë dhe në arsim.

Një mundësi e humbur për Prishtinën


Me gjithë madhësinë e kryeqytetit, vetëm 7% e serbëve nga Kosova juglindore, udhëtojnë atje një herë në javë ndërsa vetëm 16% një herë në muaj. Një e treta udhëtojnë rrallë në kryeqytet. Përderisa institucionet lokale duhet të gjejnë mënyra se si ta bëjnë qytetin më tërheqës dhe mirëpritës, serbët e Kosovës duhet ta tejkalojnë shqetësimin që ndërlihet me këtë vend.

Prej atyre pak serbëve që udhëtojnë në Prishtinë, gati gjysma e tyre e bëjnë këtë për qëllime të punës. Gati një e pesta bëjnë shopping në Prishtinë, ndërsa një e dhjeta vizitojnë mjekun. Më pak se një e dhjeta udhëtojnë në Prishtinë për marrje të dokumenteve dhe përqindja e njëjtë udhëtojnë për të vizituar familjen apo miqtë. Pra, asnjë serb nuk e viziton Prishtinën për arsim apo argëtim.

Sa shpesh udhëtoni në Prishtinë?



Qëllimi i udhëtimeve në Prishtinë?



Ka pak që Prishtina mund të bëjë për të rritur përqindjen e atyre që vizitojnë miqtë apo për qëllime të arsimit, por fushat në të cilat autoritetet qendrore mund të punojnë janë punësimi dhe shëndetësia e avancuar. Shoppingu, sporti dhe argëtimi po ashtu mund të rriten duke iu afruar komunave përmes përdorimit më të kujdesshëm të gjuhëve të komuniteteve.

Rëndësia e Graçanicës

Komuniteti më i madh i serbëve në jug të lumit Ibër është i vendosur në Graçanicë dhe rrethinë. Pas vitit 1999, KFOR-i ka mbrojtur manastirin me postbloqe. Edhe pse këto postbloqe tanimë janë hequr, ekziston një përshtypje që ky komunitet ende jeton në një enklavë, përkundër fakti që është i vendosur në rrugën kryesore nga Gjilani dhe është vetëm 10 minuta larg Prishtinës.

Para konfliktit, Graçanica ka qenë një zonë rurale, mirëpo pas vitit 1999 një numër i konsiderueshëm i elitës serbe të Kosovës është vendosur këtu. Manastiri shërben si burim i krenarisë kombëtare dhe shpirtërore.

Gjeografikisht, Graçanica është e vendosur mjaft mirë për tu shndërruar në një qendër urbane për serbët e Kosovës. Kjo komunë e re me 131,25 km², ka 18.642 banorë. Përbërja etnike është me 85% serbë (15,972), 4% shqiptarë (689), dhe 10.6% të tjerë (1,981).


Komuna ka krijuar departamentet kryesore administrative, përkatësisht Drejtorinë për Administratë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shërbime Publike, Bujqësi, Buxhet dhe Financa, Planifikim Urban dhe Kadastër, Rini dhe Sport si dhe Inspektorat. Që nga themelimi, Komuna ka aprovuar Rregulloren e Punës dhe legjislacionin e rëndësishëm për zhvillimin e vet ekonomik (si p.sh. Rregulloren për pronën e paluajtshme, Taksa, Lejet e Punës për Biznese, etj.)

Kur diskutohen mundësitë e një zone të banuar me serbë e cila është në gjendje t'i përmbush nevojat dhe interesat e të rinjve serbë, sytë menjëherë drejtohen kah Graçanica. Fatkeqësisht, kapacitetet e Graçanicës për të përmbushur këto pritje janë të kufizuara. Barrikatat dhe distanca e largët janë pengesat kryesore kundër shndërrimit të Mitrovicës në një qendër për serbët e Kosovës, prandaj Graçanica duhet të shfrytëzohet këtë mundësi dhe të konkurrohet për këtë primat rëndësie. Argumentet që e mbështetin këtë janë: (a) lokacioni qendror dhe distanca e arsyeshme nga shumica e


zonave të banuara me serbë në Kosovë, (b) manastiri, dhe (c) afërsia me kryeqytetin.

Institucionet dhe donatorët tanimë kanë investuar shumë në Graçanicë dhe buxheti për komunën është rritur nga viti në vit. Projektet kanë përfshirë rregullimin e shtratit të lumit, qendra sportive, kopsht të fëmijëve, një stacion televiziv dhe një investim të madh për një qendër spitalore. Aktualisht, komuna ka vetëm një shtëpi shëndeeti që ofron shërbime bazike mjekësore. Pacientët shkojnë në Mitrovicë dhe Vranjë apo në Beograd dhe Nish për kujdes special shëndetësor.

Sa shpesh udhëtoni në Graçanicë?



Qëllimi i udhëtimeve në Graçanicë?




Rëndësia e Graçanicë matet me frekuencën e udhëtimeve të serbëve nga Kosova juglindore në këtë komunë. Afër gjysma e tyre rrallë udhëtojnë në Graçanicë dhe një e treta së paku një herë në muaj. Më pak se një e pesta udhëtojnë aty çdo javë.

Më pak se një e treta vizitojnë Graçanicën për qëllime shëndetësore. Më pak se një e pesta e të anketuarve vizitojnë Graçanicën për qëllime të argëtimit përderisa 15% për të vizituar miqtë dhe familjen. Në përqindje më të ulët, serbët e

vizitojnë këtë komunë për këto qëllime: 13% për blerje, 12% për punë dhe biznes, 5% për arsim përderisa kultura, sporti dhe lëshimi i dokumenteve përbën 6% të arsyeve për vizitë në Graçanicë.

Suksesi i ekipeve sportive në Serbi edhe më tutje e minimizon mungesën e qendrave sportive për serbët në Kosovë. Komuna e Graçanicës ka vendosur si prioritet kulturën dhe sportin dhe ka për qëllim realizimin e projekteve të mëdha që pritet të sjellim përfitime për gjithë rajonin e Kosovës qendrore.

Çfarë nevojitet që Graçanica të bëhet qendër urbane



Për transformim të Graçanicës, shumica e të anketuarve do të preferonin shërbime më të mira mjekësore (28%), ngjarje kulture (26%) dhe transport më të mirë publik (24%). Sporti dhe kultura shihen si prioritet nga më pak se 10% e të anketuarve. Derisa të përmirësohen shërbimet dhe punësimi, këto do të vazhdojnë të kërkohen në Mitrovicë, Vranja, Nishi, Kragujevci, apo edhe Beograd. Sidoqoftë, trendet për Graçanicën parashihet që të përmirësohen.

Integrimi i rinisë serbe në shoqërinë kosovare varet drejtpërsëdrejti nga përpjekjet e komunave si Graçanica për

të ofruar një mjedis urban. Çdo herë që një person udhëton për të kërkuar një shërbim, shtohet mundësia për tu rritur arsyet për migrim të përhershëm. Sa më shumë që zhvillohet Graçanica, aq më pak serbët do të kërkojnë vende të tjera për të marr arsimin e lartë, shërbime mjekësore më cilësore, ngjarje sportive dhe aktivitete të tjera argëtuese.

Shtërpca

E vendosur në Kosovën jugore, në kufi me Maqedoninë, Shtërpca është një komunë me shumicë serbe që përbëhet nga 16 fshatra. Në krahasim me Graçanicën, që është afër Prishtinës, Shtërpca është më e izoluar dhe gjendet rreth 100 km larg pikës më të afërt kufitare me Serbinë. Popullsia e saj llogaritet të jetë afër 13.500 banorë, prej të cilëve 9.100 janë serbë dhe 4.500 janë shqiptarë. Prej tyre, rreth 700 deri në 1.000 janë serbë të shpërngulur nga Ferizaj apo Prizreni si dhe refugjatë nga Kroacia. Shumica kanë qenë duke jetuar në qendra kolektive në Brezovicë që nga viti 1999 apo 2004.

Aktivitetet kryesore ekonomike të Shtërpcës janë bujqësia dhe turizmi. Para vitit 1999, shumë serbë që kanë jetuar në Shtërpcë kanë punuar në komunat përreth. Shumica e bizneseve të sotme janë të vogla dhe udhëhiqen brenda familjes dhe papunësia mbetet e lartë. Komuna më së shumti njihet për qendrën skitare në Brezovicë dhe parkun nacional që shtrihet në katër komuna. Qendra turistike është potenciali më i mirë i Kosovës për skijim por duke e pasur parasysh gjendjen e tij të mjerueshme, është e vështirë të besohet që në kohën e vet më të mirë, ky resort ka tërhequr mbi 120.000 mysafirë në vit. Kjo qendër ka shërbyer si alternativë gjatë Lojërave Olimpikë Dimërore të Sarajevës të vitit 1984. Me investime dhe menaxhim adekuat, potenciali i Brezovicës mund të tejkalojë edhe konkurrentët rajonal.

Qendra mjekësore e Shtërpcës ka shtatë nën-stacione dhe ambulanta në fshatrat përreth. Qendra mjekësore ka afër 300 të punësuar lokalë, prej të cilëve disa janë mjekë të

zhvendosur nga komunat e Ferizajt apo Prizrenit. Shumica e fshatrave në këtë komunë kanë qasje në ujë të pijes, por rrjeti i ujësjellësit është akoma me gypa të vjetër që përmbajnë material të rrezikshëm si asbesti. Në vitet e fundit Shtërpca është përballur me ndërprerje të shumta të rrymës elektrike. Në anën tjetër, infrastruktura rrugore është përmirësuar dukshëm.

Shtërpca ka pak gjasa që të shndërrohet në një qendër të rëndësishme, ajo shpesh konsiderohet si komuna me mundësitë më të mira ekonomike, jo vetëm në kuadër të komunave serbe por në të gjithë Kosovën. Në aspektin afatgjatë, komuna mund të absorbojë shumë serbë por edhe shqiptarë për punësim sezonal apo të përhershëm. Turizmi gjatë gjithë vitit do të tërheq turistë jo vetëm nga Kosova, por edhe nga Serbia. Një rritje e tillë do t'i ndihmojë komunës që të krijojë ekonomi të qëndrueshme dhe potencialisht mund të josh serbët nga zonat rurale të Kosovës që të vendosen aty. Komuna duhet të dedikojë një pjesë të konsiderueshme të resurseve të saj në modernizimin e turizmit për tërë vitin.

Për shkak të distancës së Shtërpcës me zonat e tjera serbe, transporti publik duhet të bëhet prioritet. Për të përmirësuar integrimin e serbëve në Kosovë, përmirësimi i sistemeve të komunikimit dhe transportit është një domosdoshmëri. Siç e ka potencuar një serb që udhëton çdo ditë për punën e tij në një hotel në Shtërpcë, transporti publik ia vështirëson arritjen në punë. Për të udhëtuar në Prishtinë, Pejë apo Prizren, duhet të ndërrohen shumë linja. Një shembull tjetër është ai i Vesnës, që punon si administratore në PTK në Prishtinë. Ajo udhëton çdo ditë nga shtëpia e saj në Graçanicë për në Prishtinë dhe mungesa e transportit të rregullt ndikon negativisht në orarin e saj të punës. Sipas Gordana Gjoriq, përfaqësuese e organizatës jo-qeveritare Avenija nga Llapnasella, transporti publik nga dhe për në Prishtinë është problematik për shkak të kërkesës shumë të

vogël. Për shkak që shkalla e punësimit është shumë e ulët në këto anë, numri i punëtorëve që kanë nevojë të udhëtojnë jashtë komunave të tyre është shumë i ulët.

Përfundime

Ekziston një nevojë e qartë në Kosovë për zona urbane që plotësojnë nevojat e serbëve të Kosovës por që sjellin po ashtu edhe bashkëpunim efektiv ndëretnik. Qendra të tilla urbane do të shërbejnë si qendra arsimore, ekonomike dhe kulturore, që u mundësojnë popullatës serbe qasje në shërbime themelore afër shtëpive të tyre dhe që mundësojnë ruajtjen e qarkullimit të të ardhurave të tyre brenda shtetit dhe jo në Serbi. Graçanica dhe Shtërpca kanë potencialin më të madh për zhvillim. Megjithatë, pyetjet që ende mbesin janë: çfarë duhet bërë në mënyrë që të ndihmohen Graçanica dhe Shtërpca për të krijuar kapacitete për ofrim të shërbimeve që lidhen me qendra urbane? Si mund të sigurojë Kosova qasje të barabartë për serbët në Prishtinë dhe zonat e tjera urbane nëpër Kosovë? A do të arrihet qëllimi i integritetit të serbëve në shoqërinë kosovare përmes krijimit të qendrave të tilla urbane?

Është me rëndësi që të mos hiqet dorë nga procesi i kthimit, por prioritet kryesor duhet dhënë ruajtjes së popullsisë aktuale dhe të sigurohet që serbët e Kosovës bëjnë plane afatgjatë, të investojnë në dyqane, punojnë tokën – me pak fjalë të vendosin të dy këmbët në Kosovë.

Një popullatë e shpërndarë kërkon transport efikas në mënyrë që të ketë qasje në shërbimet e centralizuara si në arsim, shëndetësi dhe kulturë. Është thelbësore zvogëlimi i nevojës për të udhëtuar jashtë vendit dhe për të ofruar shërbime atraktive nga komunat me shumicë shqiptare në mënyrë që rritet ndërveprimi në mes të komuniteteve. Ky përqendrim i komunitetit serb në disa zona më të mëdha

duhet të përkrahët së bashku me transportin publik efektiv që i lidh zonat e vogla të izoluara me këto “qendra”.

Çelësi për transformimin e një komune si Graçanica qëndron në investime të menduara mirë në infrastrukturë dhe kapacitete njerëzore. Shumë serbë të rinj udhëtojnë në Mitrovicë, Vranjë dhe Nish për shkuar në shkollë apo në universitet, të ndjekin aktivitete kulturore apo sportive apo për shopping. Megjithëse këto nuk janë shërbime themelore, disa nga këto shërbime duhet të ofrohen më afër shtëpisë, në qytete më shumicë shqiptare apo serbe.

Shumica e serbëve udhëtojnë për shërbime shëndetësore. Afër gjysma e serbëve të Gjilanit udhëtojnë për qëllime shëndetësore, si në Graçanicë, Vranjë apo në Prishtinë. Është thelbësore që komuniteti serb të ndjehet rehat kur i viziton qendrat që janë më afër shtëpisë. Shërbimet që kërkohen në Vranjë apo Mitrovicë duhet të zëvendësohen me shërbime që ofrohen në Graçanicë apo Gjilan, përderisa shërbimet më të avancuara duhet të jenë të qasshme në Prishtinë.

Qasja në arsim cilësor është problematike. Pothuajse të gjitha komunat ofrojnë shërbime të shkollimit fillor dhe të mesëm të një cilësie të ulët. Për studentët që dëshirojnë të ndjekin shkollimin profesional ata duhet të shkojnë në Mitrovicë apo në universitete në Serbi, ngase në Kosovë nuk ka opsione të tjera. Po të kishte kërkesë për personel me aftësi të lartë profesionale mund të inkurajojë të diplomuarit që të mos kthehen në shtëpi.

Pas përfundimit të reformave të nevojshme legislative për decentralizimin, hapi i ardhshëm që komunat duhet të ndër marrin është investimi në projekte të zhvillimit të qëndrueshëm urban që do t'i plotësoj nevojat e banorëve të tyre. Është skajshmërisht e rëndësishme (veçanërisht në Shtërpcë) që të përkrahët sektori private, sidomos biznesi i

vogël, në mënyrë që banorët të shfrytëzojnë resurset natyre për zhvillim ekonomik të turizmit, blegtorisë, dhe bletarisë.

Serbëve të Kosovës u mungon qasja edhe në shërbime të zakonshme si shoppingu, që është edhe një nga arsyet kryesore e përmendur për udhëtim në Serbi. Më shumë se një e pesta e serbëve nga Gjilani i kryejnë blerjet në Vranjë dhe një përqindje e përafërt në Prishtinë. Disa nga ta i kryejnë blerjet edhe në Graçanicë apo Mitrovicë. Ngjashëm, shumica e serbëve nga Shtërpca i kryejnë furnizimin në Ferizaj. Blerjet janë një mënyrë e shkëlqyeshme e krijimit të ndërveprimit në mes të komuniteteve shumicë dhe pakicë në Kosovë.

Megjithëse argëtimi është veçori kryesore e qyteteve të mëdha, praktikisht asnjë serb nuk shkon në Prishtinë për këtë qëllim. Pavarësisht distancës, shumica e serbëve kërkojnë argëtimin në Graçanicë, pastaj në Vranjë dhe Mitrovicë. Tabela e mëposhtme ilustron një përshkrim të përgjithshëm se ku kërkojnë shërbimet aktualisht dhe ku mund të ofrohen këto shërbime për një qasje më të lehtë nga banorët.

Niveli i ofrimit të shërbimeve		
	Aktualisht	Potencialisht
Shërbimet shëndetësore sekondare	Vranjë dhe Graçanicë	Graçanicë, Shtërpcë, Prishtinë
Dokumente personale	Vranjë	Në çdo komunë
Shtëpi të kulturës	Në çdo komunë por janë jo-funksionale	Në çdo komunë
Blerje	Jashtë komunave të vogla, kryesisht në Vranjë, Prishtinë dhe Mitrovicë.	Gjilan, Prishtinë, Graçanicë
Ngjarje kulturore	Mungesë e ngjarjeve të mëdha kulturore, kryesisht kërkohen në Vranjë dhe Mitrovicë.	Graçanicë dhe Prishtinë
Argëtim	Më së shumti në Graçanicë dhe Vranjë.	Të krijohen mundësitë në Prishtinë
Sport	Pak ngjarje sportive në komunat e tyre, kërkohen në komuna më të largëta.	Në Graçanicë, Shtërpcë dhe komuna me shumicë shqiptare
Punësim	Në komunat e tyre dhe Vranjë	Në çdo komunë, në masë më të madhe në Graçanicë dhe Prishtinë
Arsimi i lartë	Mitrovicë	Mitrovicë
Shëndetësi e avancuar	Beograd	Beograd dhe Prishtinë

Rekomandime

Analiza e situatës aktuale tregon për potencial për shërbime prioritare në disa lokacione të caktuara në mënyrë që të promovohet integrimi, të adresohen shqetësimet dhe të plotësohen nevojat dhe interesat. Një mbështetje më e madhe me shërbime që ofrohen brenda Kosovës do të përmirësonte qëndrueshmërinë, si dhe integrimin dhe ndërveprimin ndëretnik. Si përfundim, PER-K ofron këto rekomandimet për hisedarët në vijim:

Autoritetet e Kosovës dhe partitë politike

Përkushtim i përgjithshëm për decentralizim dhe të drejta të pakicave. Të ndërpriten tendencat për ri-centralizim, trende të cilat janë vërejtur kohët e fundit ku qeveria qendrore po rimerr kompetencat nga komunat. Procesi i decentralizimit duhet të finalizohet në mënyrë efektive dhe duhet të përqafohet si një parim i ri i qeverisjes. Autoritetet duhet të ofrojnë qëndrime që shprehin shqetësimin dhe zotimin e saj për qëndrueshmërinë e komunitetit serb.

Autoritetet e Kosovës në mënyrë aktive duhet të përmirësojnë imazhin e Qeverisë së Kosovës në mesin e serbëve përmes realizimit të projekteve zhvillimore që pozitivisht do të ndikojnë në komunitetin serb. Për të larguar skepticizmin e kahmotshëm të komunitetit serb kundrejt Qeverisë së Kosovës, duhet të ketë një përqendrim në ofrimin e rezultateve specifike siç janë përkrahja dhe fuqizimi i ligjit për gjuhët dhe përkrahje qeveritare për projektet kulturore. Një gjest i fuqishëm simbolik i Qeverisë së Kosovës do të ishte përkthimi dhe shpërndarja e dokumenteve të rëndësishme në gjuhën serbe që mund të përdoren nga komunat me shumicë serbe.

Përmirësimi i transportit publik. Qeveria e Kosovës duhet të investojë në përmirësimin e transportit publik në mes të Prishtinës dhe komunave me shumicë serbe.

Investime me fokus në Graçanicë dhe Shtërpçë për të ndihmuar zhvillimin e këtyre komunave në qytete të qëndrueshme që ofrojnë një mjedis urban. Këto ide mund të përfshijnë hapjen e departamenteve të arsimit profesional në bujqësi, turizëm dhe financimin e ngjarjeve kulturore dhe sportive.

Komunat me shumicë serbe

Kompletimi i legjislacionit dytësor për të zbatuar decentralizimin në mënyrë adekuate. Kryetarët serb duhet të punojnë së bashku si dhe me Asociacionin e Komunave për të gjetur përgjigje për problemet e përbashkëta me të cilat përballen ata dhe për të lobuar kundër tendencave për marrjen e kompetencave nga komunat.

Planifikimi strategjik afatgjatë. Komunat serbe duhet të punojnë se bashku për të identifikuar përparësitë krahasuese të tyre në sektorin privat, dhe të ndihmojnë donatorët për të koordinuar asistencën e tyre. Mbi të gjitha, ata duhet të bëjnë planifikime afatgjata; të angazhohen në rritjen e kapaciteteve dhe infrastrukturës për të siguruar që një asistencë e tillë do të jetë efektive. Kryetarët nuk duhet t'i shohin komunat si feude, por duhet të punojnë së bashku për gjetjen e zgjidhjeve për nevojat e shumta që nuk mund t'i arrijnë individualisht.

Graçanica si një qendër. Kryetari i Graçanicës duhet t'i bashkërendojë të gjithë hisedarët, duke përfshirë Qeverinë e Kosovës, kryetarët e tjerë, Qeverinë e Serbisë dhe donatorët e tjerë, për të përmirësuar atë çfarë mund të ofrojë Graçanica. Arsimi, shëndetësia, shoppingu dhe argëtimi duhet të jenë fusha prioritare që duhet të përmirësohen. Qëllimi duhet të jetë ofrimi i shërbimeve kualitative për të

garuar me tërheqjen që kanë Vranja dhe Mitrovica për serbët.

Turizmi dhe vendet e punës në Shtërpcë. Komuna e Shtërpcës duhet të asistohet në hapjen e një qendre arsimore për turizëm dhe gastronomi. Kjo nuk do t'i shërbente vetëm komunës dhe planeve afatgjata të komunës për punësim, por do të jositte edhe serbët dhe shqiptarët nga e gjithë Kosova. Një numër i mësimdhënësve dhe administratorëve nga qendrat aktuale arsimore mund të gjejnë punë në një fushë më të qëndrueshme dhe produktive. Panairë vjetore dhe ngjarje kulturore duhet të planifikohen për Shtërpcën.

Qeveria e Serbisë

Të kalohet nga lëmosha në investime. Qeveria e Serbisë nuk duhet të zvogëlojë shumën e fondeve që i jep për serbët e Kosovës. Megjithatë, paratë në formë të ndihmës sociale vetëm sa dëmtojnë qëndrueshmërinë. Autoritetet e Beogradit duhet gradualisht të transformojnë natyrën e asistencës dhe të kalojnë nga lëmosha në grante dhe kredi për aktivitete të ndërmarrësisë. Kreditë e buta duhet të kanalizohen në mënyrë specifike në sektorët e mbingarkuar e që mund të rezultojnë me përjashtime nga puna, si në administratë, siguri, gjykata, apo potencialisht edhe në sektorin e telekomit.

Inkurajimi i pjesëmarrjes në institucione. Përkundër raporteve problematike me Kosovën, Qeveria e Serbisë duhet të udhëzojë komunitetin serb në Kosovë (së paku në jug) që të marrin pjesë në jetën publike në Kosovë dhe të shfrytëzojnë shërbimet që ju takojnë. Mediat në Serbi duhet të vazhdojnë të jenë kritike, ashtu siç edhe ju takon. Por rekomandohet që ata të ofrojnë një perspektivë më të balancuar duke ofruar edhe storie të suksesit në programet e tyre. Kjo do të ndihmojë në rritjen e besimit në hapësirat publike në Kosovë.

Komuniteti i donatorëve ndërkombëtar

Fokus i njëjtë si për kthim ashtu edhe për zhvillim të qëndrueshëm. Komuniteti ndërkombëtar duhet të fokusojë asistencën e vet në qëndrueshmëri të rinisë dhe të familjeve. Donatorët duhet të kalojnë fokusin e tyre nga procesi i kthimit dhe të ndihmojnë komunitetin serb që të përfshihet në sektorin privat, qendrat rekreative, transportin dhe kulturën. Duhet të prioritetizohen mundësitë për arsim të lartë dhe punësim që absorbojnë rininë serbe në llojet e angazhimit që i lidhin ata me investimet e tyre, p.sh. kreditë për hapjen e hoteleve në Shtërpçë.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

316.346.32-053.6(=163.41:496.51)

323.15-053.6(=163.41:496.51)

Perspektiva e një të riu serb në Kosovë / Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë / Përgatitur nga Leon Malazogu, Viktor Popoviq, Shpend Emini ; redaktuar në shqip nga Valmir Ismaili. - Prishtinë : Project on Ethnic Relations, 2012. - 64 f. : ilustr. ; 20 cm.

1. Malazogu, Leon 2. Popoviq, Viktor 3. Emini, Shpend 4. Ismaili, Valmir

ISBN 978-9951-8865-0-5

Që nga viti 2000 PER - Kosovë ka kontribuar në përmirësimin e dialogut politik ndëretnik dhe ka ndihmuar në integrimin e komunitetit serb. Duke filluar nga vera e vitit 2012, PER - Kosovë do të vazhdojë të funksionojë si program i Demokracisë për Zhvillim (D4D). Hulumtimi i politikave publike dhe tryezat rajonale do të identifikojnë mundësitë për përmirësuar tutje mirëbesimin ndëretnik dhe të adresojë çështjet praktike për ndërtimin e një mjedisi ndëretnik tolerant brenda Kosovës.



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni www.d4d-ks.org.



B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Kingdom of
the Netherlands

ISBN 978-9951-8865-0-5



9 789951 886505